





AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Hartim, Menaxhim Projektsh”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Prof.Asoc.Dr. Arjan Qefalia 

2. Dr. Olta Nexhipi 

Mars 2023

Për Programin e studimit Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh”
4	Urdhëri/VKM i licensimit:	UMASR Nr. 347 datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit (2 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.A 2021-2022 - 7 PAE/0 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A 2021-2022 16 studentë të rregjistruar
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Përshkrim përmbledhës;

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh” është një program studimi me kohë të plotë, me 60 kredite, që ofrohet në 2 semestra apo 1 vit akademik, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilave merret diploma me profilin përkatës. IAL “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” e ka marrë lejen për hapjen e institucionit në zbatim të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë si shkollë e lartë private mesdhetare bazuar në VKM nr.177, datë 19/02/2009: “Për dhënien e lejes për hapjen e Institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”.

Me Urdhërin nr.347, datë 17/09/2021 të Ministrit të Arsimit, Sporti dhe Rinisë, është hapur programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në ‘Hartim, Menaxhim Projektsh’, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.

Programi i studimit MP në “Hartim, Menaxhim Projektsh”, ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, njësi e vendosur në Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.

IAL “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e ‘Kartës së Bolonjës’ dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së misionit të IAL “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” të përcaktuar në Statutin e IAL “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” (siç cilësohet tek Aneksi: Evidenca 1 e tij).

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit MP në “Hartim, Menaxhim Projektsh”, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të IAL “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në politika zhvillimi, identifikimin dhe vlerësimin e projekteve, buxhetimin dhe analizën e projekteve, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, si në sektorin publik edhe atë privat.

Ky raport u përgatit nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të akreditimit për programin e studimit Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh”.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Prof.Asoc.Dr. Arjan Qefalia dhe Dr. Olta Nexhipi. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Arjana Alija, përfaqësuese e ASCAL.

Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qenë kriteret e vendosura në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit Master Profesional në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vizitat në institucion u kryen në datën 13 dhe 14 Qershor 2022. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL, dhe gjithashtu gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca të ndryshme për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit të nivelit MP në “Hartim, Menaxhim Projektsh”. Programi i studimit MP në “Hartim, Menaxhim Projektsh” është i atashuar pranë Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.

Programi i studimit Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh” është në proces akreditimi për herë të parë.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është MSc. Arjana Alija.

Më datë 03/02/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 44/1 Prot., datë 03/02/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 340 Prot., 13/02/2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

Sqarim: GVJ në hartimin e RVJ është bazuar në evidencat e dorëzuara nga IAL pranë ASCAL para dhe pas vizitës fizike në IAL UMSH, si dhe bazuar në vizitën dhe diskutimet & takimet e bëra në IAL UMSH. Sa më sipër, në mënyrë më të detajuar, qëndrimet e GVJ jepen si vijon:

GVJ në FUSHA I – Standarti I.2 ... Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij. – Kriteri 3 ... Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. Fq.6: ... GVJ sugjeron që programi të ofrohet ndërdepartamental, ose të ofrohet nga një departament i cili ka formimin e duhur për të ofruar këtë program studimi. .

Komente nga GVB: Programi një vjeçar MPHMP është hartuar në përputhje me fusha akademike të institucionit, duke e bazuar realizimin e tij në bashkëpunim ndërmjet departamenteve. Siç evidentohet në RVB dhe në planin mësimor (Evidenca 15. Tabelat për programin, Tab. 4) nga 9 aktivitete formuese të programit, 6 prej tyre (përfshirë praktikën dhe diplomën) ofrohen dhe realizohen me angazhimin direkt të anëtarëve të departamentit përgjegjës për programin. Lëndët e reja ofrohen nga lektorë të cilët, pavarësisht se janë anëtarë të departamenteve të tjera të UMSH, kanë përvoja të spikatura në projekte, në pozicione konform disiplinave që zhvillojnë në këtë program. Kështu është mundësuar hartimi i syllabuseve dhe mësimdhënia në përputhje me standartet e cilësisë institucionale që në vitin e parë të realizimit të programit. Sugjerojmë të rishikohet formulimi i mësipërm i RVJ.

Komente nga GVJ: Sa më sipër është sugjerim. GVJ mendon që duhet rishikuar mënyra e organizimit të programit.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA I – Standarti I.4 ... Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për

programin e studimit në institucion.. – Kriteri 2 ... Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. **Fq. 8-9** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit *nuk është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në kurrikul programit të studimit i është dhënë një qasje e hartimit dhe menaxhimit të projekteve në administratën publike, ndërkohë që programet në fushën e menaxhimit të projektit, pavarësisht prapashitesës që marrin, formimin e kanë në fushën menaxheriale dhe financiare.* Pjesa më e madhe e studentëve të cilët janë pjesë e këtij programi janë të punësuar në institucione publike ose në OJF. *GVJ konstaton, si dhe më lart përmendur, që programi dhe lektorët e e tij duhet të jenë më shumë nga departamenti që e ofron atë, pasi kjo i jep mundësinë njësisë bazë që të kuptojë më mirë problematikat e studentëve dhe ndryshimet e nevojshme në kurrikul.*

Komente nga GVB: Programit i është dhënë një qasje e tillë, pasi projektet po shtohen gjithnjë e më shumë në Administratën Publike dhe në institucionet arsimore, shëndetësore dhe të mirëqënies, artistike e të tjera fusha, pavarësisht nëse ato menaxhohen nga punonjës të sektorit publik apo privat. Plani mësimor përfshin edhe lëndë të menaxhimit dhe financës në projektet që ofrojnë njohuri të mjaftueshme për zbatim në praktikën e punës me projekte, brenda hapësirave të një programi profesional. Sqarimi për numrin e lëndëve të programit që jepen nga anëtarët e departamentit janë dhënë më lartë.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë çfarë është vënë si evidencë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA I – Standarti I.5 - Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit. – Kriteri 3 ... Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike,

praktikave të punës apo stazhit etj. – Fq: 10 ... Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi t'i vihej në dispozicion një marrëveshje e posaçme për këtë program studimi. Por një evidencë e tillë nuk është vënë në dispozicion të GVJ.

Komente nga GVB: Sqarojmë se marrëveshjet e bashkëpunimit që UMSH ka nënshkruar më një numër institucioneve i shërbejnë institucionit në nivel fakulteti dhe programi studimi, në vecanti për zhvillimin e praktikave profesionale në fushat konkrete të këtyre programeve. Në rastin e këtij programi marrëveshja me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, është ka ofruar mundësi të drejtpërdrejta për studentët dhe është materializuar edhe me një projekt të përbashkët (Dhjetë partner vendas dhe të huaj) <https://usia.al/partners/ccit/>.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë çfarë është vënë si evidencë. GVJ gjykon se mundësia e kësaj evidence është domosdoshmëri, ndaj dhe e ka kërkuar si evidencë shtesë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA I – Standarti I.5 - Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit. – Kriteri 5 ... Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. -Fq. 10: ... Në takimin e zhvilluar me zyrën e karrierës GVJ u informua se UMSH mban kontakte me studentët Alumni dhe i fton ata në mënyrë të vazhdueshme në leksionet e hapura të ofruara nga UMSH. GVJ-së i është vënë në dispozicion evidence për ruajtjen e kontakteve të Alumni por jo evidencë e ftesës së studentëve në të tilla aktivitete.

Komente nga GVB: Nuk ka akoma një brez Alumni për këtë program studimi. Sugjerojmë që kjo shprehje të modifikohet në raportin e RVJ-së.

Komente nga GVJ: GVJ gjatë vizitës në IAL ka kërkuar një procedurë standarte, jo specifikisht për këtë program.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin. Por është sugjerim.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.1 ... Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. Kriteri 5 ... Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. **Kriteri 6 ...** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. . - **Fq. 11-12 :** ... bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion vërehet se janë të specifikuar kategoritë formuese me lëndët përkatëse, çdo lëndë në këtë program studimi ka një peshë me 6 kredite. Në kategorinë e lëndëve bazë kemi politikat e zhvillimit. Në kategorinë e lëndëve karakterizuese ka 4 lënde të profilit si hartimi i projekteve, risku, monitorimi dhe planifikimi. Në kategorinë e lëndëve me zgjedhje studentëve u ofrohet mundësia të zgjedhin mes 2 lëndëve si sjellje Organizative dhe Kuadri European i Projekteve.keto te dhena i marrim nga kurrikula e vendosur ne dispozicion. Ndërsa nga lista e syllabuseve vërejmë një mospërpuethshmëri pasi ka më shumë lëndë më zgjedhje se lëndët e listuara në kategorinë C në kurrikul.

Komente nga GVB: Plani mësimor është dokumenti bazë për të gjykuar mbi raportet e krediteve, orëve dhe aktiviteteve formuese të programit. Nëse ka ndonjë mospërputhje në listën e syllabuseve, kjo mund të jetë rezultat i ndonjë lapsusi gjatë plotësimit të syllabuseve nga pedagogët përkatës.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje është bazuar në atë çfarë është vënë në dispozicion si evidencë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.2 ... Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. – Kriteri 3 ... Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar. – **Fq. 13** Nga evidencat e vëna na dispozicion GVJ vëren se në këtë program studimi nuk ka staf me kohë të pjesshme të angazhuar. Vetëm 2 nga anëtarët e njësisë bazë japin mësim në program, 4 lektorë janë nga fakultete të tjera të UMSH-së ndërsa 2 lektorë nga njësia kryesore që ofron këtë program studimi. Gjatë vizitës në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

institucion GVJ u informua se mos angazhimi i stafit me kohë të pjesshme vjen për shkak të ruajtjes së cilësisë në këtë program studimi. GVJ gjykon se është e nevojshme përfshirja e lektorëve me kohë të pjesëshme të vilët janë specialist të fushave të projektit. Kjo përfshirje rrit cilësinë e formimit të studentëve.

Komente nga GVB: Sqaruar më lartë te Standart I.2 , Kriteri 3.

Komente nga GVJ: Sa më sipër është sugjerim. GVJ mendon që duhet rishikuar mënyra e organizimit të programit.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.2 ... Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. – Kriteri 4 ... Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. – Fq. 13 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike .Sipas Evidencës nr 10, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka një përbërje prej 27 anëtarësh. Pesë në kategorinë “Profesor” gjashtëmbëdhjetë në kategorinë “Doktor”, dhe gjashtë në kategorinë “Asistent Lektor” Njësia bazë që ofron këtë program studimi përbëhet nga shtatë anëta rë me kohë të plotë. Ndër të cilët 2 në kategorinë “Profesor” dhe pesë në kategorinë “Doktor”. Shohim një përputhshmëri ligjore në qëndrueshmërinë e njësisë bazë, por jo në ofrimin e programit të studimit. Sic është përmendur dhe në standartin I.4, kriteri 2, njësia bazë dhe kryesore e këtij programi studimi është shumë pak e përfshirë në ofrimin e programit.

Komente nga GVB: Sqaruar më lartë te Standart I.2 , Kriteri 3.

Komente nga GVJ: Sa më sipër është sugjerim. GVJ mendon që duhet rishikuar mënyra e organizimit të programit.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.4 ... Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. - Kriteri 9 ... Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. - **Fq. 16:** ... Gjithashtu institucioni zotëron një qendër për projektet (evidenca nuk u vu në dispozicion pas vizitës) e cila ndihmon studentët në aftësimin e tyre dhe përputhjen me kërkesat e tregut.

Komente nga GVB: Qendra e Projekteve është përshkruar në RVB dhe aktiviteti i saj evidentohet në faqen zyrtare të UMSH. Një nga projektet e fundit është <https://usia.al/about-project/>.

Komente nga GVJ: GVJ gjykon se vendosja në dispozicion e kësaj evidence ka qenë e nevojshme.



Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin. Por është sugjerim.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.5 ... Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit. - Kriteri 1 ... Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. . - **Fq. 17:** ... I gjithë stafi është personel me kohë të pjesëshme

Komente nga GVB: Sugjerojmë të saktësohet shprehja, pasi më lartë është theksuar se i gjithë stafi është me kohë të plotë.

Komente nga GVJ: Lapsusi do të pasqyrohet i ndryshuar në RVB.

Komenti merret parasysh, por nuk ndryshon vlerësimin.



GVJ në FUSHA II – Standardi II.5 ... Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit. - Kriteri 2 ... Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. - **Fq.18:** ... *Në këtë program studimi angazhohen 8 lektorë të cilët janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH. Dy prej tyre janë pjesë e departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë ndërsa pjesa tjetër janë lektorë të cilët vijnë nga jashtë departamentit. Lektorët që përfshihen në mësimdhënien e programit të studimit bazuar në CV e vëna në dispozicion zotrojnë formimin e nevojshëm për lektorimin e lëndëve. GVJ gjykon se një numër më i lartë i lëndëve duhet të ofrohet nga departamenti dhe jo nga lektore jashtë tij pasi kjo ndikon në cilësinë e programit të studimit.*

Komente nga GVB: Sqaruar më lartë te Standart I.2 , Kriteri 3.

Komente nga GVJ: Sa më sipër është sugjerim. GVJ mendon që duhet rishikuar mënyra e organizimit të programit.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.5 ... Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit. - Kriteri 5 ... Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. **Fq.18:** ... *Bazuar në takimet e zhvilluara në UMSH dhe bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion studentët të këtij programi studimi nuk zhvillojnë orë laboratorike. Kjo konstatohet nga evidencat e vendosura në dispozicion, si plani mësimor apo syllabuset e programit të studimit. Gjithashtu edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët u vu në dukje se për këtë program studimi nuk zhvillohen orë laboratorike.*

Komente nga GVB: Programi nuk parashikon orë laboratorike, në kuptimin e ngushtë të punës në laborator. Por kjo nuk nënkupton mospërdorimin e kompjuterave dhe sistemeve informatike, të cilat janë në dispozicion dhe përdoren për mësimdhënien dhe punën individuale të studentëve. Sugjerojmë të rishikohet formulimi i mësipërm në RVJ.

Komente nga GVJ: GVJ i është referuar orëve laboratorike të mirëfillta, pasi përdorimi i laboratorëve dhe ambienteve të UMSH në dispozicion të studentëve janë sqaruar në Standartet përkatëse të raportit.

Komenti merret parasysh, por nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.3 ... Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor. - Kriteri 3 ... Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. - **Fq.23:** ... *Për realizimin e procesit mësimor, sallat e UMSH -së janë të pajisura me projektor dhe kompiuter, gjë e cila ndihmon në zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu IAL-ja ngarkon stafin ndihmës akademik të cilët ndihmojnë në problematikat e ndryshme që mund të ndeshet stafi gjatë përdorimit të këtyre materialeve. Studentët e këtij programi studimi ende nuk disponojnë sisteme informatike të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me programin. - Kriteri 7 ...* Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. - **Fq.23:** ... *Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se ata kanë akses në laboratorët e institucionit të cilat mund të përdoren për qëllime studimore, si realizim të detyrave të kursit, përpilimit të diplomave, zgjidhjen e ushtrimeve, etje. Studentët e këtij programi nuk zhvillojnë lëndë specifike në laboratore, thjesht i përdorin për nevoja dytësore. Aktualisht nuk ka softëare specifike për këtë program studimi, gjë e cila do t'i vinte në ndihmë studentëve për formimin e tyre.*

Komente nga GVB: Infrastruktura e konsoliduar e IT në dispozicion të të gjithë studentëve të UMSH iu jep mundësinë studentëve të programit MPHMP të përdorin të gjitha programet e menaxhimit të projekteve që lidhen me planifikimin, skedulimin, buxhetimin, monitorimin-kontrollin, menaxhimin e riskut etj (Minimalisht paketa Microsoft Office).

Komente nga GVJ: Menaxhimi i projektve është një fushë specifike dhe në koment GVJ është shprehur vetëm në lidhje me programet specifike të cilat mund të përdoren në funksion të studentëve.

Komenti merret parasysh, por nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.4 ... Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. - Kriteri 2 ... Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. - **Fq. 24-25:** ... Ndër problematikat e vëna në dukje nga GVJ është fakti se pasja e një numri të lartë të stafit akademik jashtë njësisë bazë vështirëson procesin e kontrollit të cilësisë. Njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies, por kjo përgjegjësi vështirësohet për shkak të shpërndarjes së stafit akademik në njësi bazë jashtë njësisë përgjegjëse.

Komente nga GVB: Përfshirja e pedagogëve jashtë njësisë bazë, nuk ka rezultuar problematike. Përkundrazi, pjesëmarrja ndërdisiplinore e pedagogëve është një vlerë e shtuar e këtij programi studimi. Për shembull, prania e pedagogëve që vijnë nga Departamenti i Ekonomikut, rrit aftësinë e përpilimit të një analize ekonomike apo studimi tregu e nevojshme për studentët që marrin një formim në Hartimin dhe Menaxhimin e projektve.

Komente nga GVJ: GVJ sqaron se problematika e shprehur lidhet me procesin e kontrollit të cilësisë në mësimdhënie.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.6 ... Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. - Kriteri 6 ... Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. - **Fq. 27:** ... Në kodin e etikës së UMSH-së si dhe në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi i kushtohet një vemëndje e veçantë plagjiaturës, kopjes dhe evitimit të saj. Në takimin

me NJSBC u bëmë me dije se për procesin e kontrollit UMSH përdor dhe programe antiplagjiature. GVJ-së nuk i janë vënë në dispozicion evidenca në lidhje me këtë proces.

Komente nga GVB: Përdorimi i programeve antiplagjiaturë, nuk lidhet drejtpërdrejtë me këtë program. Sugjerojmë të rishikohet shprehja në RVJ.

Komente nga GVJ: Programet antiplagjiaturë nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me një program studimi.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin. Por është sugjerim.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.7 - Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore. - Kriteri 1 ... Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. - **Fq. 28:** ... *GVJ sugjeron pasurimin e kurrikulës me lëndë me zgjedhje të cilat i vijnë në ndihmë studentit në formimin e tij.*

Komente nga GVB: Nga nëntë aktivitete formuese në program, dy prej tyre përfshijnë katër lëndë me zgjedhje. Rritja e numrit të tyre do të cënonte raportin e ETCS të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi (% e lëndëve ndërdisiplinore dhe me zgjedhje - C ndaj totalit të krediteve).

Komente nga GVJ: GVJ i referohet larmishmërisë së lëndëve me zgjedhje dhe jo ndryshimeve numrin e krediteve.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.7 - Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore. . - Kriteri 5 ... Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. **Fq. 28:** ... *Në faqen web të UMSH gjendet një numër i madh me staf akademik të ftuar ose të brendshëm që organizon leksione të hapura për të informuar studentët në lidhje me çështje të ndryshme. GVJ-ja gjykon se këto*

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

14

leksione duket të jenë më të fokusuar për këtë program studimi duke qenë se leksionet janë me karakter të përgjithshëm.

Komente nga GVB: Megjithëse është në vitin e parë të realizimit të tij, ky program ka përfituar nga organizimi i leksioneve të hapura të lidhura drejtpërdrejtë me çështjet që mbulon ai. Për ilustrim link-u bashkangjitur
<https://vvvvvv.umsh.edu.al/d/329/masteri-i-ri-në-umsh-zhvillohet-leksion-i-hapur-projektet-e-be-se-aplikim-menaxhimi-dhe-auditimi-i-tyre>.

Komente nga GVJ: Kjo evidencë nuk është vënë në dispozicion të GVJ-së.

Komenti merret pjesërisht parasysh por GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.7 - Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore. - Kriteri 7... Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara....- **Kriteri 8 ...** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. **Fq. 28:** ... *Gjatë zhvillimit të leksioneve, personeli akademik angazhon studentët në punë në grup në mënyrë që të rritet ndërveprimi me studentëve. Personeli akademik ka një marrëdhënie komunikimi të vazhduar me studentët në mënyrë që të nxisë idetë inovatore. GVJ-ja gjykon se duhet të kishte më shumë evidence të cilat vënë në dukje këto ndërveprime dhe nxitje të studentëve kah kërkimit shkencor apo shfaqjes së ideve inovatore.*

Komente nga GVB: Në vijim linku për një projekt të fituar nga studentët që kanë patur mbështetjen e shkollës: <https://m.facebook.com/people/tirana-ime-Ndryshe-panairi-i-ideve/100085493314765>.

Komente nga GVJ: Kjo evidencë nuk është vënë në dispozicion të GVJ-së.

Komenti merret parasysh, por GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.7 - Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore. - Kriteri 9... Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. - **Fq.29:** ... *Institucioni nxit studentët të jenë pjesë e ideve innovative dhe kërkimit shkencor. Programi që marrim në shqyrtim është një program Master profesional në të cilin studentët janë më shumë të fokusuar drejt zhvillimi të praktikës dhe marrjes së dijeve praktike. Kjo mund të vihet në dukje dhe nga mesatarja e studentëve në hyrje. Gjatë takimit të zhvilluar me studentët na u bë me dije se ata janë mbështetur nga institucioni për aplikimin në një projekt fitues (evidenca nuk u vu në dispozicion pas vizitës) dhe një pjesë e studentëve ishin ende të angazhuar në këtë projekt. Institucioni nuk ka planifikuar financime të posaçme për studentët.*

Komente nga GVB: Në vijim link-u për një projekt të fituar nga studentët, që ka patur mbështetjen e shkolles:

<https://m.facebook.com/people/Tirana-ime-ndryshe-Panairi-i-Ideve/100085493314765/>

Sugjerohet të rishikohet formulimi i mësipërmë në RVJ

Komente nga GVJ: GVJ ka gjykuar vetëm bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.5 ... Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit. - Kriteri 1 ... Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. - **Fq. 44:** ... *GVJ sugjeron që duhej miratuar dhe paraqitur dhe një Rregullore e Sekretarisë Mësimore!*

Komente nga GVB: Institucioni disponon një Rregullore të Sekretarisë Mësimore, e cila nuk është vënë si evidencë, pasi nuk lidhet direkt me programin në fjalë.

Komente nga GVJ: Është thjesht sugjerim, por GVJ mendon që duhej vënë si evidencë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin ... por siç u tha më lart, është thjesht sugjerim.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.5 ... Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit. - Kriteri 2 ... Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. - Fq. 45: ... GVJ sugjeron që duhej miratuar dhe paraqitur dhe një Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore!

Komente nga GVB: Institucioni disponon një Rregullore të Zyrës së Burimeve Njerëzore, e cila nuk është vënë si evidencë, pasi nuk lidhet direkt me programin në fjalë.

Komente nga GVJ: Është thjesht sugjerim, por GVJ mendon që duhej vënë si evidencë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin ... por siç u tha më lart, është thjesht sugjerim.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.6 ... Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.- Kriteri 1 ... Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. - Fq. 48: ... GVJ sugjeron që duhej një raport më i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi.

Komente nga GVB: Dokumenta të tilla hartohen në nivel institucioni dhe janë të disponueshme në zyrat përkatëse.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë çfarë është vënë si evidencë, dhe mendon që duhej vënë si evidencë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.6 ... Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.- Kriteri 2 ... Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. - **Fq. 48:** ... *Nga GVJ sugjerohet që duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vete!).*

Komente nga GVB: Dokumenta të tilla hartohen në nivel institucioni dhe janë të disponueshme në zyrat përkatëse.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë çfarë është vënë si evidencë, dhe mendon që duhej vënë si evidencë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA V – Standardi V.4 ... Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm- Kriteri ... 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre. - **Fq. 60:** ... *Nga GVJ sugjerohet që të bëhet më shumë punë për të rritur numrin e regjistrimeve të studentëve që ndjekin studimet MP në Hartim, Menaxhim Projektesh, kjo për të ndikuar në të ardhurat e IAL UMSH, por dhe për të fuqizuar këtë program studimi dhe për ta përmirësuar më tej.*

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

18

Komente nga GVB: Institucioni bën përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim. Ky është vetëm viti i parë i zhvillimit të programit. Rezultatet do të evidentohen në vijim.

Komente nga GVJ: Është thjesht sugjerim.

GVJ nuk ndryshon vlerësimin ... por siç u tha më lart, është thjesht sugjerim.

GVJ në FUSHA V – Standardi V.5 ... Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.- Kriteri 1 ... Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. - **Fq. 62:** ... *GVJ mendon që duheshin dhe vendimet e emërimit të përfaqësuesve të studentëve në Senat dhe Këshillat Studentore!*

Komente nga GVB: Ky dokumentacion ndodhet në arkivat përkatëse. Mund të ishin vënë në dispozicion të grupit të GVJ po të ishin kërkuar.

Komente nga GVJ: Nga GVJ janë kërkuar dhe GVJ mendon që duheshin vënë në dispozicion.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA V – Standardi V.5 ... Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.- Kriteri 3 ... Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. - **Fq. 63:** ... *(GVJ konstaton se ka një mosperputhje të krediteve të lëndëve mes rregullores së programit edhe evidencës përmbledhëse numër 10!). ... (GVJ mendon që është bërë një lapsus te tabela e evidencës 10 ... janë harruar pa u vendosur 60 orë në auditor dhe 90 orë jashtë auditorit tek njëra nga lëndët me zgjedhje!).*

Komente nga GVB: Në fakt ka një lapsus në tabelën e evidencës nr.10, të cilin e korrigjuam dhe ja bashkangjisim këtij dokumentacioni tabelën e saktë.

Komente nga GVJ: Merret parasysh dhe reflektohet në RVJ, pra hequr pjesët më lart (me italic) pas komenteve dhe korrigjimit të bërë nga GVB.

Komenti merret parasysh dhe GVJ ndryshon vlerësimin.



GVJ në FUSHA VI – Standardi VI.1 ... Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.-

Kriteri 2 ... Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. - **Fq. 69:** ... *GVJ sugjeron që 1 student duhet të përfshihej si anëtar tek NjSBCZhK (edhe pse studentët përfshihen tek GVB e krijuara për akreditimin e programeve të ndryshme të studimit). Si dhe ka një mospërputhje për numrin e anëtarëve të NjSBCZhK ... në rregulloren e UMSH thuhet 7 anëtarë, përfaqësues të njësive kryesore të IAL, tek Evidenca 10 & nga takimi me përfaqësues të NjSBCZhK thuhet 10 anëtarë, kurse te RVB thuhet 9 anëtarë, ku përfshihet dhe 1 student (por tek vendimi i emërimit të NjSBCZhK nuk citohet që ka student)?! Si dhe duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata.*

Komente nga GVB: Sqarojmë se NJSBCZHK-ja ka anëtar student, siç evidentohet në tabelën 24, Evidenca 15, duke respektuar kështu aktet rregullatore në fuqi. Rritja e numrit të anëtarëve të njësisë është bërë me qëllim zgjerimin e aktivitetit të saj dhe një monitorim më të plotë të të gjitha proceseve që ndjek njësia.

Komente nga GVJ: Pas dërgimit të komenteve nga GVB, komenti i GVJ në RVJ do të jetë: *Ka një mospërputhje për numrin e anëtarëve të NjSBCZhK ... në rregulloren e UMSH thuhet 7 anëtarë, përfaqësues të njësive kryesore të IAL, tek Evidenca 10 & nga takimi me përfaqësues të NjSBCZhK thuhet 10 anëtarë, kurse te RVB thuhet 9 anëtarë, ku përfshihet dhe 1 student?! Si dhe duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata.*

Komenti merret pjesërisht parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.



GVJ në FUSHA VI – Standardi VI.2 ... Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteri 1 ... Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë. - **Fq. 72:** ... *GVJ konstaton që mungon vendimi i emërimit të anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësive kryesore, programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët, si dhe duhej më shumë informacion për punën dhe arritjet e këtij komisioni.*

Gjithashtu, GVJ sugjeron që NjSBC të ishte e 'pastër' dhe më e fokusuar, kurse për pjesën e kurrikulave të krijohej Komision i Përhershëm për Zhvillimin e Kurrikulave, dhe puna e tij të ishte më e specializuar dhe fokusuar, gjë e cila do të sillte më shumë efikasitet dhe efektivitet.

Komente nga GVB: Ky dokument ekziston dhe gjendet në arkivën e njësive kryesore. Nuk është vendosur si evidencë, pasi nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë me programin.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje bazohet te ajo që kërkon kriteri i standardit dhe bazuar në evidencë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA VI – Standardi VI.4 ... Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

- **Kriteri 1 ...** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. - **Fq. 78:** ... *GVJ konstaton që mungon vendimi i emërimit të anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësive kryesore (ku bën pjesë dhe 1 student), programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët. Si dhe duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata.*

Komente nga GVB: Sqaruar në pikat e mësipërme, përkatësisht Standardi VI.2., kriteri 1 dhe Standardi VI.4, kriteri 1.

Komente nga GVJ: Per korrektesë: këtu po flitet për standardin VI.4., kriteri 1! Pas dërgimit të komenteve nga GVB, komenti i GVJ në RVJ do të jetë: *GVJ konstaton që mungon vendimi*

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

21

i emërimit të anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë kryesore (ku bën pjesë dhe 1 student), programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët. Si dhe duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata.

Komenti merret pjesërisht parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin, por është sugjerim.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT


Standardi I.1			
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi Master profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh” i ofruar nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë është në përputhje me qëllimet, misionin e institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të tij. <i>Evidenca:</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu 1, Neni, Pika 2 (e)		
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit “Hartim, Menaxhim Projektsh” ofrohet në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. GVJ vë në dukje se statuti dhe rregullorja e institucionit theksojnë elementë si: misioni, niveli i mësimdhënies, kërkimi shkencor, specializimi i stafit, etj dhe realizimi i këtij programi studimi mbështetet në këto pika të cilat vënë në dukje ruajtjen e cilësisë. Bazuar në <i>Evidencën 2 dhe Evidencën 3</i> drejtimit prioritarë të programit janë në përputhje me statutin dhe rregulloren e UMSH-së.		
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve si dhe përgjatë vizitës së zhvilluar në IAL grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që e ofron këtë program. <i>Evidenca:</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH, Evidenca 2. Plani strategjik i Zhvillimit Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit MPHMP		
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve si dhe përgjatë vizitës së zhvilluar në IAL, grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që e ofron këtë program. <i>Evidenca:</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 2. Plani strategjik i Zhvillimit Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit MPHMP Evidenca 9. Analiza e tregut të punës		
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

23




standardit	plotësisht	kryesisht	plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektësh” i ofruar nga UMSH është në përputhje me qëllimet, misionin e institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të tij. <i>Evidenca:</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 2. Plani strategjik i Zhvillimit Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit MPHMP
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Ky program Studimi ofrohet në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. GVJ vë në dukje se statuti dhe rregullorja e institucionit theksojnë elementë si: misioni, niveli i mësimdhënies, kërkimi shkencor, specializimi i stafit, etj dhe realizimi i këtij programi studimi mbështetet në këto pika të cilat vënë në dukje ruajtjen e cilësisë. Drejtimit prioritar të programit janë në përputhje me statutin dhe rregulloren e UMSH-së. <i>Evidenca:</i> Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit MPHMP
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve si dhe përgjatë vizitës së zhvilluar në IAL grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore. Gjithashtu, <i>GVJ vëren dhe vuri në dukje gjatë vizitës në IAL se njësi bazë që e ofron këtë program nuk ka përputhshmëri me programin e ofruar për shkak të përbërjes së saj. Vetëm 2 lëndë nga programi i studimit mbulohen nga njësi bazë. Bazuar në ligjin për arsimin e lartë dhe VKM-të mbështetëse, njësi bazë është përgjegjëse për hartimin e kurrikulës dhe miratimin e syllabuseve. Në këto kushte GVJ mendon se kjo njësi bazë nuk mund të kontrollojë cilësinë e këtij programi studimi duke qënë se nuk mbulon as 50% të lëndëve në këtë program. GVJ sugjeron që programi të ofrohet ndërdepartamental, ose të ofrohet nga një departament i cili ka formimin e duhur për të ofruar këtë program studimi. .</i> <i>Evidenca:</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 2. Plani strategjik i Zhvillimit Evidenca. Tabela për stafin akademik Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të	GVJ eidenton se ky program studimi është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Pasi në ditët e sotme i jepet një rëndësi e veçantë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

24

zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	zhvillimit të projekteve dhe menaxhimit të tyre në mënyrën e duhur. Kjo vihet në dukje bazuar në Evidencën 3 e cila specifikon zhvillimin strategjik të këtij programi dhe përputhshmërinë e tij me interesin kombëtar dhe jo vetëm.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Dokumentacioni i vënë në dispozicion të GVJ na mundëson të identifikojmë se Programi i studimit ka të përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve dhe përfshin dijet, aftësitë dhe kompetencat që duhet të zotërojë një i diplomuar në programin master Profesional “Hartim, Menaxhim Projektesh”. <i>Evidenca:</i> Evidenca 7. Rregullore e programit MPHMP
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Evidenca 9 na jep një pasqyrë të qartë të analizës së zhvilluar në tregun e punës përpara hapjes së këtij programi studimi. Na vihen në dispozicion analizat e zhvilluara nga organizata të ndryshme dhe kërkesën që ka tregu për kapacitete në fushën e “Hartim, Menaxhim Projektesh”. IAL-ja në punën e saj dhe në rregulloret që zotëron ka të specifikuar mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me tregun e punës dhe me institucionet në të cilat këto student janë të punësuar. Por, nuk ka evidence për këtë program studimi duke qënë se është një program i ri dhe ende nuk ka një brez të diplomuarish. <i>Evidenca:</i> Evidenca 9. Analizë e tregut të punës Evidenca 4. Rregullore e UMSH Evidenca 5. Rregullore e FSHPSP
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Objektivat formuese të këtij programi studimi si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit evidentohen në rregulloren e programit të studimit si dhe në analizën e tregut të zhvilluar përpara hapjes së programit. Bazuar në kurrikulën e ofruar student që ndjek këtë program studimi aftësohet për tu përballur me tregun dhe ka mundësi në procesin e punësimit.
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Gjatë vizitës në institucion GVJ-ja u informua se hartimi i kurrikulës është bërë duke u bazuar në kurrikula bashkëkohore dhe në eksperiencën e anëtarëve të departamentit. GVJ-ja kërkoi t’i vihen në dispozicion kurrikulat e ngjashme në të cilat është bazuar departamenti për hartimin e këtij programi studimi, por kjo evidencë nuk është vënë në dispozicion.

<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disaveqare të institucionit dhe praktikata e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. <i>Evidenca:</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH</p>		
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Studentët që ndjekin masterin profesional "Hartim, Menaxhim Projektsh" kanë të përfshirë në kurrikulën e tyre procesin e praktikës i cili zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. <i>Evidenca:</i> Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP Evidenca 13. Formularët dhe raporti standart i praktikës Evidenca 28. Rregullore për praktikata</p>		
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Ky program ofrohet në gjuhën shqipe. Gjatë vizitës GVJ u informua se për nevoja apo marrëveshje të veçanta, në të ardhmen programi apo lëndë specifike të tij mund të zhvillohen dhe në gjuhë të huaja pasi lektorët kanë aftësitë e duhura për të ofruar lëndë në gjuhë të huaj. <i>Evidenca:</i> Evidenca 11. CV e stafit akademik të programit të studimit</p>		
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë "Master profesional" janë në përputhje me fushën akademike të njësies kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë operon në tregun shqiptar që në vitin 2009 i organizuar në tre fakultete dhe 9 departamente, zotëron kapacitetet për të ofruar këtë program studimi. Angazhimi i Universitetit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare gjithashtu është një faktor që ndikon pozitivisht në krijimin e kapaciteteve për ofrimin e këtij programi. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua mbi mundësitë dhe kapacitetet për ofrimin e programit si dhe angazhimin e institucionit në trajnimin dhe zhvillimin e stafit për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit <i>nuk është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë,</i></p>

<p>akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p><i>përgjegjëse për programin e studimit. Në kurrikul programit të studimit i është dhënë një qasje e hartimit dhe menaxhimit të projekteve në administratën publike, ndërkohë që programet në fushën e menaxhimit të projektit, pavarësisht prapashitesës që marrin, formimin e kanë në fushën menaxheriale dhe financiare. Pjesa më e madhe e studentëve të cilët janë pjesë e këtij programi janë të punësuar në institucione publike ose në OJF. GVJ konstaton, si dhe më lart përmendur, që programi dhe lektorët e e tij duhet të jenë më shumë nga departamenti që e ofron atë, pasi kjo i jep mundësinë njësisë bazë që të kuptojë më mirë problematikat e studentëve dhe ndryshimet e nevojshme në kurrikul.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</p>		
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Hartim, Menaxhim Projektsh” është në përputhje me drejtimit e ofruara nga institucioni ndaj sigurimi i cilësisë është një proces i cili përmbushet nga vete ky i fundit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 2. Plani strategjik i Zhvillimit Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit MPHMP</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi I.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programi i Studimit “Hartim, Menaxhim Projektsh” përbëhet nga 7 lëndë ndër të cilat 2 lëndë ofrohen nga njësia bazë e “Administrimit Publik dhe Formimit Bazë” ndërsa pjesa tjetër nga lektorë me kohë të plotë të Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Marrëdhënia mes departamenteve sigurohet me anë të rregulloreve të institucionit. Gjithashtu, gjatë vizitës GVJ u vu në dijeni se gjatë takimeve periodike në njësinë bazë analizohet mbarëvajtja dhe ecuria në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 4. Rregullore e UMSH Evidenca 5. Rregullore e FSHPS Evidenca 6. Rregullore e DAPFB</p>

	Evidenca 15. <i>Procesverbal mbledhje për diskutim vitin akademik 2021-2022</i>			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në dokumentacionin e dërguar nga institucioni GVJ nuk kishte një pasqyrë të qartë në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit që zotëronte institucioni. Me kërkesë të GVJ institucioni vuri në dispozicion marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani të ndryshme si dhe me institucionet e huaja të cilat ofrojnë mundësinë e mobiliteteve për studentët. <i>Evidenca:</i> Evidencë 2.1 <i>Model marrëveshje Erasmus + dhe listë e marrëveshjeve të UMSH</i> Evidencë 2.24 <i>Listë e marrëveshjeve me Universitetet</i>			
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion GVJ u informua nga zyra e marrëdhënieve me jashtë se institucioni zotëron një numër të madh marrëveshjesh me bizneset të cilat janë në funksion të programeve të studimit të ofruara nga institucioni. <i>Gjate vizitës në institucion GVJ kërkoi t'i vihej në dispozicion një marrëveshje e posaçme për këtë program studimi. Por një evidencë e tille nuk është vënë në dispozicion të GVJ.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	<i>Evidenca:</i> Evidencë. <i>Analiza vjetore e UMSH- (online)</i>			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar të bashkërendim me punëdhënësit.	Në takimin e zhvilluar me zyrën e karrierës GVJ u informua se UMSH mban kontakte me studentët Alumni dhe i fton ata në mënyrë të vazhdueshme në leksionet e hapura të ofruara nga UMSH. GVJ-së i është vënë në dispozicion evidencë për ruajtjen e kontakteve të Alumni por jo evidenca e ftesës së studentëve në të tilla aktivitete. <i>Evidenca:</i> Evidenca 16. <i>Formular I Studentit Alumni</i> Evidenca 2.22. <i>Model Tabel excel për ruajtjen e të dhënave Alumni</i>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Njësia bazë “Administrimit Publik dhe Formimit Bazë” harton në mënyrë periodike analizë të programeve të studimit të ofruar prej saj. Ky program studimi nuk ka një analizë të tillë duke qënë se nuk është mbyllur ende një cikël studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht
---	--	-----------------------	----------------------------------	-----------------------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Hartim, Menaxhim Projektsh” është i shpërndarë në vite dhe semestra si dhe i organizuar në kredite dhe orë mësimore në përputhje të plotë me ligjit për arsimin e lartë 80/2015 si dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018 si dhe aktet nënligjore në mbështetje të këtij ligji. Në përfundim të studimeve studenti duhet të plotësojë 60 Kredite (ETC) të cilat janë të shpërdara në një vit akademik.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në kurrikulën e vënë në dispozicion GVJ-ja mendon se plani mësimor i këtij programi studimi realizon formimin e shprehive të veçanta për hartimin, menaxhimin e projekteve. Lëndët e ofruara në këtë program studimi kanë në fokus specializimin e studentëve në Hartim, Menaxhim Projektsh dhe i ndihmojnë studentët të formohen në pikat më të rëndësishme të projekteve siç janë rëndësia e politikave të zhvillimit, buxhetimi, analiza e riskut, monitorimi i projekteve, etj. Fokusi dhe rëndësia e këtyre tematikave të lartëpërmendura ndikojnë në të kuptuarit kritik dhe parimeve kryesore të projekteve. Gjatë ndjekjes së këtij programi studentit i krijohet mundësia për të krijuar aftësi dhe kompetenca të avancuara dhe i jepet mundësia të zhvillojë këto kompetenca në mënyrë analitike për të qënë i përgatitur me terrenin në të cilin do të përballet.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Ky program studimi është i organizuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndë bazë (Simboli A) -10 % , 6 Kredite 2. Lëndë karakterizuese (Simboli B) – 40%, 24 Kredite 3. Lëndë ndërdisiplinore integruese (Simboli C) – 20%, 12 Kredite 4. Lëndë plotësuese (Simboli D) – 10%, 6 Kredite 5. Detyrime përmblyëse (Simboli E) – 20%, 12 Kredite <p><i>bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion vërehet se janë të specifikuara kategoritë formuese me lëndët përkatëse, çdo lëndë në këtë program studimi ka një peshë me 6 kredite. Në kategorinë e lëndëve bazë kemi politikat e zhvillimit. Në kategorinë e lëndëve karakterizuese ka 4 lëndë të profilit si hartimi i projekteve, risku, monitorimi dhe planifikimi. Në kategorinë e lëndëve me zgjidhje studentëve u ofrohet mundësia të zgjedhin mes 2 lëndëve si sjellje Organizative dhe Kuadri Evropian I Projekteve.keto te dhena i marrim nga kurrikula e vendosur ne dispozicion. Ndërsa nga lista e</i></p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

29

	<p><i>syllabuseve vërejmë një mospërpuethshmëri pasi ka më shumë lëndë më zgjedhje se lëndët e listuara në kategorinë C në kurrikul. Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</i></p>		
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Duke u bazuar në specifikën dhe në qasjen që ka ky program një element i rëndësishëm i tij është zhvillimi i procesit të praktikës mësimore. Kjo mund të evidentohet në planin mësimor si dhe në procedurat e praktikës. Gjithashtu gjatë vizitës GVJ u informua se si institucioni zotëron një qendër për të nxitur studentët drejt aplikimit në projekte dhe zbatimin e tyre. Kjo qendër zotëronte praktika të mëparshme të pjesëmarrjes së studentëve në projekte dhe në zbatimin e tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 8. <i>Syllabuse program studimi</i> Evidenca 28. <i>Udhëzues për praktikat</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim. FSHSP bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton e organizuar në tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Politike 2. Departamenti i Psikologjisë Sociale 3. Departamenti i Administrimit Publik <p>Departamenti i Administrimit Publik Përbëhet nga 7 anëtare ndër ta: 4 me grada dhe tituj ndërsa pjesa tjetër në kërkim të gradës Doktor. Ky staf angazhohet në procesin mësimor dhe të kërkimit shkencor. Stafi akademik përmbush detyrimet ligjore për pjesën e mësimdhënies, gjë e cila vërehet nga ngarkesa mësimore që ata marrin në UMSH. Gjithashtu ata janë të angazhuar edhe në procesin e kërkimit shkencor i cili është individual, por dhe i mbështetur nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 1. <i>Statuti i UMSH</i> Evidenca 6. <i>Rregullore e DAPFB</i> Evidenca 10. <i>Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të</p>	

<p>pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>informua se mos angazhimi i stafit me kohë të pjesshme vjen për shkak të ruajtjes së cilësisë në këtë program studimi. <i>GVJ gjykon se është e nevojshme përfshirja e lektorëve me kohë të pjesëshme të vilët janë specialist të fushave të projektit. Kjo përfshirje rrit cilësinë e formimit të studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 10. <i>Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</i></p>						
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike .Sipas Evidencës nr 10, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka një përbërje prej 27 anëtarësh. Pesë në kategorinë “Profesor” gjashtëmbëdhjetë në kategorinë “Doktor”, dhe gjashtë në kategorinë “Asistent Lektor” Njësia bazë që ofron këtë program studimi përbëhet nga shtatë anëta rë me kohë të plotë. Ndër të cilët 2 në kategorinë “Profesor” dhe pesë në kategorinë “Doktor”. Shohim një përputhshmëri ligjore në qëndrueshmërinë e njësisë bazë, por jo në ofrimin e programit të studimit. Sic është përmendur dhe në standartin I.4, kriteri 2, njësia bazë dhe kryesore e këtij programi studimi është shumë pak e përfshirë në ofrimin e programit.</p>						
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Praktika në këtë program studimi organizohet në formën e një lënde, pikërisht për këtë arsye nuk nevojitet angazhimi i stafit ndihmës për realizimin e praktikave mësimore.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 8. <i>Syllabuse program studimi</i> Evidenca 28. <i>Udhëzues për praktikën</i></p>						
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinators të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjës për mbarëvajtjen e punës në këtë program studimi është koordinatori i cili nuk është pjesë e njësisë bazë por është pjesë e zyrës master. Koordinatori luan një rol në mbarëvajtjen e marëdhënieve ndërdepartamentale dhe arritjen e objektiveve të programit të studimit. Gjatë takimit me GVJ koordinatori informoi në lidhje me raportimet periodike që zhvillohen ne UMSH si pjesë e detyrës së tij dhe rregulloreve të institucionit.</p>						
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p><i>Evidenca:</i> Evidenca 5. <i>Rregullore e FSHSP</i> Evidenca 10. <i>Organigrama dhe Screenshot i aktiviteteve të koordinatorsit të programit të studimit</i> Evidenca 34. <i>Rrëgullore e NJSBCZHK</i></p>						
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 1671 746 1733">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="754 1671 965 1733">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="973 1671 1177 1733">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="595 1738 746 1778"></td> <td data-bbox="754 1738 965 1778" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="973 1738 1177 1778"></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X	
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
	X						

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

31

organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë dhe ajo kryesore informohen në lidhje me ndryshimet ligjore dhe përshtasin dhe organizojnë programet e tyre në përputhje me to. Gjatë vizitës grupit të vlerësimit të jashtëm iu bë me dije se baza ligjore shpërndahet nga rektorati në adrese të njësive kryesore dhe atyre bazë me qellim përshtatjen e programeve të studimit me ndryshimet ligjore. Kjo gjë gjithashtu konstatohet në rregulloret e UMSH dhe ne Statutin e këtij Universiteti.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit është i organizuar në lëndë, praktikë dhe mbrojtje të mikrotezës sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Gjithashtu lëndët janë të vlerësuara jo vetëm me notë por dhe me kredite sipas sistemit evropian, gjë e cila i jep mundësinë studentit për njohjen e këtij programi brenda dhe jashtë vendit.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<i>Evidenca:</i> Evidenca 5. Rregullore e FSHPSP Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor i vënë në dispozicion të GVJ përfshin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, frekuentimin apo ndjekjen e programit si dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Ky plan mësimor i paraqitet studentëve dhe stafit akademik i cili ka lidhje me programin “Hartim, Menaxhim, Projektsh”. <i>Evidenca:</i> Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Pjesën më të madhe të informacioneve në lidhje me kriteret e përgjithshme apo ato specifike për pranimin, transferimin apo ekuivalentimin e programeve të studimit të interesuarit e gjejnë më së shumti në faqen zyrtare web të UMSH dhe rrjetet sociale të Universitetit. Duke qënë se ky program studimi ka vetëm një vit që operon ka vetëm procedura pranimi. Transferimet e studimeve në këtë IAL drejtohen nga institucioni, i cili bën shpalljet sipas akteve ligjore dhe udhëzimeve në fuqi, por gjithashtu ka dhe një manual për transferimin e studimeve. Gjatë takimit GVJ u informua se kriteret e pranimit përcaktohen nga departamenti dhe mund të ndryshojnë në varësi të vendimeve të departamentit. <i>Evidenca:</i> Evidenca 7. Rregullore e programit MPHMP Evidenca 14. Përmbledhje e procedurës së transferimeve
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion GVJ-ja konstaton se programi i studimit “Hartim, Menaxhim Projektsh” është i pajisur me një plan lëndor në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për secilën nga lëndët GVJ-ja pati mundësi të njihej me syllabuset përkatëse si dhe format e zhvillimit të praktikës së studentëve. Syllabuset e vëna në dispozicion janë në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 <i>Evidenca:</i>

	Evidenca 8. Syllabuse program studimi Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP Evidenca 28. Udhëzues për praktikën		
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë takimit me stafin akademik të departamentit GVJ konstatoi se përmirësimi i programeve të studimit dhe përputhshmëria me ndryshimet e tregut është një nga objektivat kryesore të departamentit të Administrimit Publik në UMSH. Departamenti zotëron procedura të ndryshimit të programeve të studimit dhe përshtatjes së tyre me kërkesat e tregut, por kjo procedurë nuk është ndjekur për këtë program studimi duke qënë se programi është i ri. Departamenti zotëron vetëm procedurën e hapjes së programit të studimit dhe kërkimet e bëra për këtë qellim. <i>Evidenca:</i> Evidenca 6. Rregullore e DAPFB Evidenca 15. Procesverbal mbledhje për diskutim vitin akademik 2021-2022		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Në përfundim të këtij programi studimi, studenti duhet të plotësojë 60 kredite. Programi i studimit zhvillohet në një vit akademik të ndarë në dy semestra. Programi i studimit është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>Evidenca:</i> Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Përzgjedhja e lëndëve të përfshira në planin mësimor të këtij programi është në përputhje të plotë me emërtimin e programit. Lëndët mundësojnë thellim të njohurive në fushën e “Hartimit, Menaxhimit të Projekteve” si dhe janë në përputhje me kurrikula të programeve të ngjashme në universitete të huaja. Ndër to mund të përmendim Hartimin e projektit, Buxhetimin e projektit, Riskun, e kështu me radhë. Ndarja mes teorisë dhe praktikës i jep mundësinë studentit të vërë në punë dijet a marra gjatë programit të studimit. Ndarja e lëndëve në semestra dhe ngarkesa në kredite është e realizuar në mënyrë të tillë që mund të përballohet nga studentët. Gjë e cila ju vu në dukje GVJ-së gjatë takimit me ta. <i>Evidenca:</i>
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

33

master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP		
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi është i organizuar në përputhje të plotë me ndarjen e veprimtarive formuese sipas legjislacionit në fuqi. Lëndët e përzgjedhura për këtë program mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve mundësinë për mobilitete si dhe mundësi punësimi për studentët me anë të marrëveshjeve që zotëron institucioni. Në këtë program studimi i jepet një vemendje e veçantë praktikës bazuar në qasjen dhe në konceptimin e këtij programi. Duke qënë se programi është profesional, institucioni angazhohet në nxitjen e studentëve drejt praktikës. <i>Evidenca:</i> Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP Evidenca 2.1. Model marrëveshje Erasmus dhe lista e marrëveshjeve të UMSH		
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Bazuar në syllabuset që u vunë në dispozicion të GVJ lëndët e ofruara në këtë program studimi janë të organizuara në literaturë të detyruar dhe literaturë të rekomanduar e cila i përket viteve të fundit. <i>Evidenca:</i> Evidenca 8. Syllabuse program studimi		
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Programi i studimit “Hartim, Menaxhim Projektsh” është i përpiluar dhe i organizuar në mënyrë të tillë që garanton përfitim të dijeve teorike dhe praktike për studentët e ciklit të dytë master profesional. Lëndët në këtë program dhe literature e cituar në syllabuse ofron mundësinë për të krijuar kompetenca dhe formim të thelluar profesional për studentët që ndjekin këtë program studimi. <i>Evidenca:</i> Evidenca 8. Syllabuse program studimi Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP		
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Duke marrë parasysh faktin se programi është i ri dhe eksperiencat janë të pakta, nga takimet e zhvilluara në institucion na u vu në dijeni se studentët kanë mundësinë për thelluar studimet e tyre në programe të tjera të ngjashme. Konceptimi i këtij programi studimi është bërë duke u bazuar në një analizë tregu e cila vë në dukje interesin e tregut për kapacitete në këtë fushë. Përmbajtja e këtij programi u jep mundësinë studentëve të formohen mbi mënyrën e hartimit të një projekti, aplikimit në të, analizën financiare të projekteve, si dhe të kenë mundësinë të marrin vendime bazuar në dijet e marra. Gjithashtu institucioni zotëron një qendër për projektet (evidenca nuk u vu në dispozicion pas vizitës) e cila ndihmon studentët në aftësimin e tyre dhe përputhjen me kërkesat e tregut. <i>Evidenca:</i> Evidenca 9. Analiza e tregut të punës Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

34


Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Në këtë program studimi për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar vetëm lektorë me kohë të plotë në UMSH, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të lektuar në programin Master Profesional.</p> <p>2 anëtare të stafit në kategorine Profesor 5 anëtare të stafit në kategorine Lektor I gjithë stafi është personel me kohë të plotë</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 10. <i>Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</i> Evidenca 11. <i>CV e stafit akademik të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Në këtë program studimi angazhohen 8 lektorë të cilët janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH. Dy prej tyre janë pjesë e departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë ndërsa pjesa tjetër janë lektorë të cilët vijnë nga jashtë departamentit. Lektorët që përfshihen në mësimdhënien e programit të studimit bazuar në CV e vëna në dispozicion zotrojnë formimin e nevojshëm për lektorimin e lëndëve. <i>GVJ gjykon se një numër më i lartë i lëndëve duhet të ofrohet nga departamenti dhe jo nga lektore jashtë tij pasi kjo ndikon në cilësinë e programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 10. <i>Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Kualifikimet e stafit të angazhuar në programin e studimit janë në përputhje me lëndët që ata ofrojnë në programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 11. <i>CV e stafit akademik të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar struktura të posaçme të cilat angazhohen në lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve. <i>Njësia bazë nuk lidh marrëveshje të posaçme, ato lidhen në nivel universiteti dhe më pas personeli i universitetit vë në zbatim këto marrëveshje me qëllim zhvillimin e praktikave apo zhvillimin e temave të diplomës.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Evidencë 2.1 <i>Model marrëveshje Erasmus + dhe listë e marrëveshjeve të UMSH</i> Evidenca 4. <i>Rregullore e UMSH</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e</p>	<p><i>Bazuar në takimet e zhvilluara në UMSH dhe bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion studentët të këtij programi studimi nuk zhvillojnë orë laboratorike. Kjo konstatohet nga evidencat e vendosura në dispozicion, si plani mësimor apo syllabuset e</i></p>

laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p><i>programit të studimit. Gjithashtu edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët u vu në dukje se për këtë program studimi nuk zhvillohen orë laboratorike të mirëfillta por përdoren labororet kompiuterike me qëllim plotësimin e nevojave të studentëve, si përgatitja individuale.</i></p> <p>Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP Evidenca 8. Syllabuse program studimi</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Për hapjen e këtij programi studimi është zhvilluar një analizë e tregut të punës e cila merr në konsideratë kërkesat dhe nevojat e aktorëve më të rëndësishëm në fushën e mënaxhimit të projektit. Ky është një fillim i mirë për këtë program. Gjatë vizitës në institucion GVJ-ja u informua se njësia bazë do të vazhdojë të mbajë kontakte me këta aktorë me qëllim që programi i studimit të jetë në përputhje me kërkesat e tregut. <i>Aktualisht për këtë program studimi nuk ka feedback në lidhje me ecurinë e programit duke qënë se programi ka vetëm një vit që zhvillohet.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 9. Analiza e tregut të punës</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, zyrën alumni dhe koordinatorin e programit të studimit GVJ-ja u informua se institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët duke ngritur struktura si fokus grupe, dhe duke zgjedhur një përfaqësues i cili qendron në kontakt të vazhdueshëm me institucionin me qëllim funksionimin dhe përmirësimin e punës në programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 17. Procedurë pune NJSBC</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Zyra Alumni dhe e Karrierës është përgjegjëse për ruajtjen e kontakteve të vazhdueshme me studentët e diplomuar duke i ftuar ata në leksione të hapura apo duke i njoftuar në lidhje me njoftime pune. Institucioni ruan një databazë të dhënash dhe e përditëson atë në mënyrë të vazhduar.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 2.21. Screenshot për njoftim mundësi punësimi nga zyra e programeve master Evidenca 2.22. Model tabele Excel për ruajtjen e të dhënave Alumni</p>

<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Në të dhënat e vendosura në dispozicion të GVJ-së vërejmë dokumentacione si marrëveshje të ndryshme që institucioni ka me institucione publike dhe private brenda dhe jashtë vendit. Programi në fjalë është një program i krijuar në përputhje me kërkesat specifike të tregut të punës. Masteri profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh” plotëson një boshllëk të tregut të punës me specialiste të kësaj fushe. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar GVJ gjykon se institucioni bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me instancat e lartpërmendura.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 9. <i>Analiza e tregut të punës</i> Evidenca 2.1. <i>Model marrëveshje Erasmus dhe lista e marrëveshjeve të UMSH</i> Evidenca 2.24. <i>Lista e marreveshjeve me Universitetet</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	------------------------------	---	------------------------------

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme institucioni organizon trajnime për stafin akademik në lidhje me metodat e inovative të mësimdhënies në varësi të fushës së studimit, gjë e cila doli në pah gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe</p>	<p>NJSBC luan një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e personelit akademik duke zhvilluar kontrole gjatë procesit mësimor, duke kontrolluar literaturën që ofrohen në auditore si dhe duke</p>

ndihmësakademik.	analizuar pyetësorët e studentëve. Bazuar në të dhenat e vendosura në dispozicion në UMSH zhvillohet metoda e vlerësimit 360 gradë. Një pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit është dhe vlerësimi i studentëve i cili zhvillohet pothuajse në përfundim të një lëndë të ndjekur. <i>Evidenca:</i> Evidenca 12. Manuali i NJSBCZHK Evidenca 2.34. Rregullore e NJSBCZHK Evidenca 17. Procedurë pune NJSBC Evidenca 23. Procedurë e punës me focus grupe Evidencë 18. Raport monitorimi dhe e vlerësimit të pedagogut		
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Gjatë takimit me NJSBC dhe lektorët, u informuam se rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion në mënyrë shpresore strukturave drejtuese dhe personave që kanë qënë pjesë e monitorimit. <i>Evidenca:</i> Evidenca 2.34. Rregullore e NJSBCZHK		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Duke shfrytëzuar marrëveshjet që zotëron IAL nxit stafin akademik të marrë pjesë në trajnime të ndryshme apo leksione të hapura me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu IAL zotëron mekanizma të ndryshme të vlerësimit të cilat inkurajojnë personelin për përmirësimin e mëtejshëm të punës.		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2


Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e dhënies së dijeve në këtë program studimi janë leksione, seminare dhe praktika mësimore. Siç është e parashikuar dhe në syllabus për çdo lëndë studentët paraqesin detyra kursi/ese apo ushtrime (në varësi të lëndës) të cilat dorëzohen në sistemin elektronik të UMSH. Syllabuset dhe mënyra e kontrollit të dijeve miratohet paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë. Institucioni gjithashtu organizon në mënyrë të vazhduar leksione të hapura me personalitete të fushës së projekteve. Kjo evidentohet në thirrjet që institucioni paraqet dhe në faqen web. <i>Evidenca:</i> Evidenca 5. Rregullore e FSHPSP Evidenca 7. Rregullore e programit MPHMP Evidenca 8. Syllabuse program studimi
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e	Gjatë takimit me lektorët e programit të studimit u diskutua në lidhje me nevojat e studentëve dhe ishte evidente gatishmëria e stafit akademik për të përshtatur metodat e mësimdhënies me nevojat e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






38

<p>mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>studentëve. U diskutua në lidhje me shembuj konkret dhe masat e marra nga lektorët për të lehtësuar mësimnxënien e studentëve. Kjo gjë u pranua edhe nga studentët në takimin me ta.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Me qëllim mbështetjen e personelit në zhvillim e kompetencave didaktike institucioni zhvillon trajnime të ndryshme si dhe angazhon lektorët në shkëmbimet Erasmus+ gjë e cila i ndihmon ata në përmirësimin e punës së tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 2. 20. <i>Trajnimi i stafit nga zyra e marëdhënies me jashtë dhe përdorimi i bibliotekës digjitale</i> Evidenca 22. <i>Programi i trajnimeve 2020-2021</i></p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 11 vërejmë se stafi akademik ka formimin e duhur për lëndët që lektoron. Referuar Evidencës 8 mund të themi se në varësi të lëndëve përdoren dhe metoda të ndryshme të shpjegimit të koncepteve dhe tematikave. GVJ pas takimit dhe me stafin akademik gjykon se lektorët përdorin metoda të ndryshme në varësi të lëndëve të tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies në UMSH vlerësohet në mënyrë periodike. NJSBC luan një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e personelit akademik duke zhvilluar kontrole gjatë procesit mësimor, duke kontrolluar literaturën që ofrohen në auditore si dhe duke analizuar pyetësorët e studentëve. Një rol të rëndësishëm në procesit e vlerësimit luajnë studentët të cilët vlerësojnë stafin akademik në përfundim të një lëndë të ndjekur dhe marrin pjesë në takimet e zhvilluara në fokus grupe me qëllim vlerësimin e metodikave të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 23. <i>Procedurë e punës me focus grupe</i> Evidencë 18. <i>Raport monitorimi dhe e vlerësimit të pedagogut</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 8 vërejmë se një pjesë e lëndëve trajtohen duke përdorur raste studimore ose ushtrime konkrete në lidhje me çështjet që diskutohen. Gjatë takimit me stafin akademik dhe më pas me studentët u vu re se në UMSH nuk mungon përdorimi i metodave interaktive gjë që e bën leksionin interesant dhe studentët marrin pjesë me kënaqësi.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Zhvillimi i detyrave të kursit, pjesëmarrja në leksione të hapura, në praktika mësimore dhe jo vetëm, bën që studenti të fitojë autonominë. Pas vizitës në institucion GVJ gjykon se marrëdhënia student-staf akademik është një marrëdhënie e shëndetshme e cila nxit formimin profesional të studentëve të cilët janë pjesë e programit të studimit “Hartim, Menaxhim Projektsh”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="596 1841 778 1908">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="778 1841 976 1908">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="976 1841 1386 1908">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, (Evidenca 2.6), UMSH siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, sallë konferencash, laboratore dhe bibliotekë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi se institucioni disponon, laboratorë, klasa, zyra, biblioteka, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, gjë e cila nuk paraqitej shumë e qartë në dokumentacionin e dorëzuar. Ndaj u kërkua ridërgimi. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastrukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimit e mësimin të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 2.6 Relacioni i Godinës (ridërgohet)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Për realizimin e procesit mësimor, sallat e UMSH -së janë të pajisura me projektor dhe kompiuter, gjë e cila ndihmon në zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu IAL-ja ngarkon stafin ndihmës akademik të cilët ndihmojnë në problematikat e ndryshme që mund të ndeshet stafi gjatë përdorimit të këtyre materialeve. <i>Studentët e këtij programi studimi ende nuk disponojnë sisteme informatike të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me programin.</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të programit, në literaturën e syllabuseve dhe gjatë bisedës me lektorët GVJ ju vu në dukje se lektorët janë duke punuar për të realizuar cikle leksionesh për studentët e këtij profili.</p> <p>Duke qenë se programi i studimit është i ri dhe me karakter profesional stafit i ka lindur nevoja të hartojë cikle leksionesh për lëndët e këtij programi studimi. Ka vonesa në përpilimin e tyre në gjuhën shqipe, sepse nuk është realizuar ende për të gjitha lëndët, por vetëm për një pjesë të tyre.</p> <p>Literatura e cila është në dispozicion ofrohet e printuar dhe elektronike në disa raste me email dhe në disa raste e hedhur në sistemin elektronik të UMSH.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin (Evidenca 13) e vënë në dispozicion nga institucioni pas vizitës së GVJ si edhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista</p>

<p>studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 2.13 <i>Lista e titujve në bibliotekë fizike dhe Online për këtë program studimi</i> Evidenca 25 <i>Kërkesë për libra DAPFB</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni zotëron një sërë marrëveshjesh dhe i jep mundësinë studentëve dhe stafit akademik të aksesojnë në librari online si Cobins, Edëard Edgar Journals, etj. Këto librari mund të aksesohen nga PC që ndodhen brenda në institucion, në bibliotekën e Universitetit, në zyrat e stafit si dhe në laboratorët e institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 25. <i>Marrëveshjet me libraritë online (pas vizitës në institucion)</i> Evidenca 26. <i>Manuali i bibliotekës online (pas vizitës në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se ata kanë akses në laboratorët e institucionit të cilat mund të përdoren për qëllime studimore, si realizim të detyrave të kursit, përpilimit të diplomave, zgjidhjen e ushtrimeve, etje. Studentët e këtij programi nuk zhvillojnë lëndë specifike në laboratore, thjesht i përdorin për nevoja dytësore. <i>Aktualisht nuk ka software specifike për këtë program studimi, gjë e cila do t'i vinte në ndihmë studentëve për formimin e tyre.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 2.6 <i>Relacioni i Godinës (ridergohet)</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>IAL përdor platformën 'SMS' në funksion të mësimdhënies. Kjo platformë shërben për informimin e studentëve mbi vlerësimin, oraret, shpërndarjen e informacionit, etj.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë COVID19 Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë adaptoi sisteme online të cilat u përdorën për procesin e mësimdhënies. Gjatë takimeve GVJ u informua se këto platforma kanë qenë efektive si për personelin akademik edhe për studentët. Gjithashtu personeli dhe studentët diskutuan mbi sfidat dhe vështirësitë e këtij sistemi. Kjo ka lehtësuar studentët në përdorimin e platformave online dhe në aksesin gjatë leksioneve.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 19 <i>Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimin online</i> Evidenca 3 <i>Screenshot platform SMS UMSH</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe</p>	<p>IAL përdor platformën 'SMS' në funksion të mësimdhënies. Kjo platformë shërben për informimin e studentëve mbi vlerësimin, oraret, shpërndarjen e informacionit, etj. Ky sistem shfrytëzohet për</p>

hapësirë vetjake të dedikuar.	komunikim të brendshëm, për akses në dokumentacionin elektronik. Çdo anëtar i UMSH-së qoftë ai student, staf akademik apo ndihmës zotëron hapësirën e tij vetjake të dedikuar në këtë sistem. <i>Evidenca:</i> Evidenca 26 <i>Udhëzues për përdorimin e sistemit SMS</i> Evidenca 3 <i>Screenshot platform SMS UMSH (pas vizitës)</i>		
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në takimin me lektorët, dhe më pas me atë me studentët, GVJ u informua se në përmblyllje të studimeve zakonisht studentët zgjedhin nëse do t'i nënshtrohen një provimi përfundimtar apo do të përgatiten për temë diplome. Kjo ndarje sakonisht bëhet në varësi të rezultateve të studentëve. Për grupin e studentëve që janë pjesë e programit nuk ka një procedurë të përgatitjes së mikrotezës pasi studentët kishin planifikuar t'i nënshtrohen provimit përmblyllës. Gjithesesi përzgjedhja e temave dhe asistimi i studentëve në realizimin e tyre është një procedurë e parashikuar në rregulloren e departamentit dhe në detyrimet e punës së stafit akademik.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	NJSBC dhe zyra master janë dy struktura përgjegjëse të organizuara nga institucioni me qëllim promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Këto instanca koordinojnë me njësinë kryesore dhe fokusohen në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo realizohet nëpërmjet proceseve të kontrollit, trajnimeve të realizuara nga institucioni dhe mobiliteteve Erasmus+ të cilat shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. <i>Evidenca:</i> Evidenca 34. <i>Rrëgjullore e NJSBCZHK</i> Evidencë 2.1 <i>Model marrëveshje Erasmus + dhe listë e marrëveshjeve të UMSH</i> Evidenca 20. <i>Plan pune MPHMP për kontrollin e procesit mësimor.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Ndër problematikat e vëna në dukje nga GVJ është fakti se pasja e një numri të lartë të stafit akademik jashtë njësisë bazë vështirëson procesin e kontrollit të cilësisë. Njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies, por kjo përgjegjësi vështirësohet për shkak të shpërndarjes së stafit akademik në njësi bazë jashtë njësisë përgjegjëse. <i>Evidenca:</i> Evidenca 10. <i>Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</i>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë	Në vazhdimësi, personeli akademik i programit të studimit "Hartim,

<p>përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Menaxhim Projektsh”, kualifikohen brenda institucionit dhe jashtë tij në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes trajnimeve, tryezave të rumbullakëta, diskutimeve, leksioneve të hapura, apo mobilitete të stafit.</p> <p>Këto aktivitete kanë shërbyer si trajnime për stafin akademik dhe përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe përshtatjes së metodave të reja në të. Pjesëmarrja e stafit akademik në këto aktivitete nxitet dhe motivohet nga njësi bazë, gjithashtu institucioni ka një buxhet të dedikuar për stafin.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 22. Programi i trajnimeve UMSH 2020-2021</p>		
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UMSH i ofron mundësinë stafit akademik të përfshihet në pjesëmarrjen në konferenca apo të angazhohen në kërkimin shkencor. Kjo bëhet me anë të financimeve që janë vendosur në funksion të stafit akademik për këtë qëllim. Evidencat tregojnë se ka investime për nxitjen e kërkimit shkencor të stafit dhe trajnime për kualifikime të këtij lloji. Stafi akademik merr pjesë në trajnime apo leksione të hapura të orgaizuara nga institucioni me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 22. Programi i trajnimeve UMSH 2020-2021 Evidenca 4. Praktikë financimi stafi për kërkimin shkencor</p>		
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies. Kjo u vu në dukje gjatë takimit që GVJ-ja zhvilloi me stafin akademik. Me qëllim nxitjen e procesit të nxënies stafi akademik përdor metoda të ndryshme dhe përdorimin e elementëve të cilat nxisin të menduarit kritik tek studentët. Këtu mund të përmendim përdorimin e rasteve të studimit, përdorimin e pjesshëm të softëareve, etje. Në takimet e zhvilluara mes tyre edhe pse të pakta, pasi i përkasin departamenteve të ndryshme, stafi akademik diskuton mbi metodat e përdorura dhe më të përshtatshme për ecurinë e procesit të mësimdhënies.</p>		
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit është i ri, nuk ka eksperiencë të angazhimit të lektorëve të huaj apo nga institucionet partnere në procesin mësimor në këtë program studimi. Gjatë takimeve, GVJ u informua se në programe të tjera ka procedura të tilla, kjo në kuadër të marrëveshjeve të institucionit.</p>		
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit është i ri, nuk ka eksperiencë të angazhimit të lektorëve të huaj apo nga institucionet partnere në procesin mësimor në këtë program studimi. Gjatë takimeve, GVJ u informua se në programe të tjera ka procedura të tilla, kjo në kuadër të marrëveshjeve të institucionit.</p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit është i ri, nuk ka eksperiencë të angazhimit të lektorëve të huaj apo nga institucionet partnere në procesin mësimor në këtë program studimi. Gjatë takimeve, GVJ u informua se në programe të tjera ka procedura të tilla, kjo në kuadër të marrëveshjeve të institucionit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

Standardi III.5			
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Informacionin mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive, dhe aftësive të posaçme që merr studenti ofrohet që në momentin që ai aplikon për tu bërë pjesë e programit të studimit. Ky informacion i shpërndahet studentëve me anë të broshurave në momentin e regjistrimit (cituar në rregulloren e programit të studimit), bëhet publike në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të UMSH-së. <i>Evidenca:</i> Evidenca 7. Rregullore e programit MPHMP		
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ në takimin me studentët shtroi pyetje në lidhje me informacionin që ata zotëronin mbi lëndët e ndjekura. Studentët na informuan se në fillim të çdo lënde ata njihen me syllabusin, tematikat, mënyrën e vlerësimit, testimet apo detyrat e kursit që duhet të dorëzojnë. Studenti pajiset me syllabus në auditor dhe e zotëron atë elektronikisht në sistemin SMS.		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Forma e vlerësimit për këtë program studimi janë forma tradicionale e testimeve. Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për zhvillimin e provimeve në mënyrë që studentët të jenë të informuar. Gjithashtu, gjatë zhvillimit të lëndëve studentët vlerësohen: Aktivizimi në seminar 10% Provimi i ndërmjetëm 30% Detyra/Projekt Kursi 20% Provimi përfundimtar 40% <i>Evidenca:</i> Evidenca 8. Syllabuse program studimi Evidenca 17. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit		
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Forma e vlerësimit për këtë program studimi janë forma tradicionale e testimeve. Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për zhvillimin e provimeve në mënyrë që studentët të jenë të informuar. Gjithashtu gjatë zhvillimit të lëndëve studentët vlerësohen: Aktivizimi në seminar 10% Provimi i ndërmjetëm 30% Detyra/Projekt Kursi 20% Provimi përfundimtar 40%

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

44

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Evidenca 8. Syllabuse program studimi</p> <p>Evidenca 17. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Format elektronike të testimeve janë përdorur nga institucioni gjatë periudhës së pandemisë. Deri më tani në këtë program studimi nuk janë eksperimentuar forma të tilla. Forma e vlerësimit për jetëgjatësinë e programit ka qënë forma tradicionale. Gjatë takimit me NJSBC dhe koordinatorin e masterit na u bë me dije se në të ardhmen mund të përdoren forma të tilla.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 17, pika 6 testimi i vlerësimit përfundimtar të studentëve bëhet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me një lektor tjetër të caktuar nga përgjegjësi i njësisë bazë. Kjo siguron transparencën në vlerësim. Gjithashtu ky proces vlerësimi u konfirmua edhe nga studentët gjatë takimit të zhvilluar me ta.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Evidenca 17. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në takimin me sekretarinë dhe studentët na u bë me dije se provimet në UMSH zhvillohen me sekretim nga ana e sekretarisë. Vlerësimi i testimeve u bëhet me dije studentëve pas procesit të ç'sekretimit dhe shoqërohet me feedback në lidhje me mangësitë që studentët kanë shfaqur gjatë plotësimit të tezave. Vlerësimi i tezave u bëhet me dije studentëve me anë të sistemit SMS.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Evidenca 17. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në kodin e etikës së UMSH-së si dhe në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi i kushtohet një vëmendje e veçantë plagjiaturës, kopjes dhe evitimit të saj. Në takimin me NJSBC u bëmë me dije se për procesin e kontrollit UMSH përdor dhe programe antiplagjiature. GVJ-së nuk i janë vënë në dispozicion evidenca në lidhje me këtë proces.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Evidenca 5 përcakton me hollësi mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe transparencën në informimin e studentëve. Studenti duhet të informohet për rezultatin deri në tre ditë nga zhvillimi i provimeve. Gjithashtu në rregulloret është përcaktuar edhe forma e hartimit të tezës.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në rregulloren e fakultetit, nëni 42 parashikohën rastet në të cilat studentit i lind e drejta për ankimim. Institucioni ka parashikuar të drejtën e studentit për tu njohur me notën dhe për tu ankimuar në rastet kur mendon se është përballur me një padrejtësi. Ankimimet e studentëve në rastet kur nuk kanë zgjidhje, kalojnë në procedura të mëvonshme të ngritjes së komisioneve të posaçme. Procedurat e</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p>	

Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	ankimimit ruhen automatikisht në sistemin SMS dhe në hard copy nga sekretaria dhe nga departamenti. Për programin e studimit në fjalë nuk ka patur procedura të ankimimit. <i>Evidenca:</i> Evidenca 5. Rregullore e FSHPSP		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.</p> <p>Bazuar në <i>planin mësimor</i> ky program studimi ka si prioritet formimin e profesionistëve të orientuar drejt fushës së menaxhimi të projektit si dhe ka si synim strategjik në lidhje me studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rritjen e cilësisë së aftësimit praktik të studentëve nëpërmjet aplikimeve të metodave bashkëkohore në fushën e menaxhimit të projektit <p><i>GVJ sugjeron pasurimin e kurrikulës me lëndë me zgjedhje të cilat i vijnë në ndihmë studentit në formimin e tij.</i></p> <p>Evidenca 10. Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje me zbatimin e VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblylëse.</p> <p>Bazuar në <i>Evidencën 10</i> dhe në takimin me studentët dhe lektorët e këtij programi studimi, programi garanton një sërë njohurish të përshtatshme për tregun e punës. <i>GVJ mendon se ka nevojë për përmirësime me qëllim që specialistët e formuar në këtë fushë të jenë eficientë në tregun e punës dhe të pajisur me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me këtë treg.</i></p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	<p>Në përfundim të procesit mësimor, sic vërehet dhe në syllabus, stafi akademik zhvillon përsëritje të lëndës dhe sëbashku me studentët analizon dijet e shkëmbyera mes palëve. Pas kësaj përsëritje studentët orientohen për procesin e testimit dhe fokusin e lëndës për këtë testim.</p> <p><i>Evidenca:</i> Evidenca 8. Syllabuse program studimi</p>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

46

orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.									
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në faqen web të UMSH gjendet një numër i madh me staf akademik të ftuar ose të brendshëm që organizon leksione të hapura për të informuar studentët në lidhje me çështje të ndryshme. GVJ-ja gjykon se këto leksione duket të jenë më të fokusuar për këtë program studimi duke qenë se leksionet janë me karakter të përgjithshëm.								
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Syllabuset e programit në studimit në lëndët karakterizuese janë të hartuara në formë të tillë që u japin mundësinë studentëve të kenë një formim teorik që ofron shembuj nga tregu real i punës. Këto njohuri studenti ka mundësi ti vërë në jetë gjatë periudhës së praktikës profesionale. IAL-ja u ofron mundësinë studentëve të zhvillojnë praktikën në institucione të ndryshme.								
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Gjatë zhvillimit të leksioneve, personeli akademik angazhon studentët në punë në grup në mënyrë që të rritet ndërveprimi me studentëve. Personeli akademik ka një marrëdhënie komunikimi të vazhduar me studentët në mënyrë që të nxisë idetë inovatore. GVJ-ja gjykon se duhet të kishte më shumë evidence të cilat vënë në dukje këto ndërveprime dhe nxitje të studentëve kah kërkimit shkencor apo shfaqjes së ideve inovatore.								
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.									
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni nxit studentët të jenë pjesë e ideve inovative dhe kërkimit shkencor. Programi që marrim në shqyrtim është një program Master profesional në të cilin studentët janë më shumë të fokusuar drejt zhvillimi të praktikës dhe marrjes së dijeve praktike. Kjo mund të vihet në dukje dhe nga mesatarja e studentëve në hyrje. Gjatë takimit të zhvilluar me studentët na u bë me dije se ata janë mbështetur nga institucioni për aplikimin në një projekt fitues (evidenca nuk u vu në dispozicion pas vizitës) dhe një pjesë e studentëve ishin ende të angazhuar në këtë projekt. Institucioni nuk ka planifikuar financime të posaçme për studentët. <i>Evidenca:</i> Evidenca 14. <i>Tabela e cilësisë së studentëve në hyrje</i>								
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Duke qenë se programi i studimit është program një vjeçar, nuk ka patur eksperiencë të shkëmbimeve Erasmus+. Në takimin me stafin akademik na u bë me dije se studentët informohen në lidhje me mobilitetet dhe mundësinë që ata kanë për të zhvilluar një semestër në universitetet partnere. Deri më tani ky program studimi nuk ka patur eksperiencë të tilla.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

47

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Për programin e studimit Master Profesional “Hartim, Menaxhim Projektsh” departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë ka hartuar një rregullore të detajuar në lidhje me zhvillimin e procesit të praktikave. Studentëve i krijohet mundësia ta zhvillojnë praktikën në njësinë e projekteve brenda UMSH-së ose në kompani apo institucione shtetërore me të cilat IAL-ja ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë praktikave studentët kanë akses në informacionin për projektet dhe mënyrën e funksionimit të tyre. <i>Evidenca:</i> Evidenca 28. <i>Udhëzues për praktikën</i> Evidenca 2.1. <i>Model marrëveshje Erasmus dhe lista e marrëveshjeve të UMSH</i>		
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Praktika mësimore për këtë program studimi zhvillohet në formën e një lënde, studentët kanë mundësinë të kenë kontakt me lektorin udhëheqës dhe të ndjekin praktikën mësimore. Kjo lëndë vlerësohet me kredite dhe notë në përfundim të saj. <i>Evidenca:</i> Evidenca 10. <i>Përmbledhje e tabelave për programin MPHMP</i> Evidenca 8. <i>Syllabuse program studimi</i>		
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	GVJ konstaton se ky program studimi përfundon, ose quhet i mbyllur në momenti që student shlyen detyrimet përmbyllëse të cilat janë me anë të mbrojtjes së temës apo provimit përfundimtar. Institucioni zotëron një procedurë të posaçme në të cilën studenti merr informacionin e duhur në lidhje me shqlyerjen e detyrimeve përmbyllëse. Studenti informohet në lidhje me këtë rregullore nga koordinatori i programit të studimit, si dhe në procesin e regjistrimit në këtë program. <i>Evidenca:</i> Evidenca 5. <i>Rregullore e FSHPSP</i> Evidenca 17. <i>Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Procesi i provimeve finale është i përshkruar qartë në rregulloren përkatëse. Komisioni administron provimet dhe teston të dhënat bazuar në literaturën e vënë në dispozicion për studentët gjatë vitit akademik që shtrihen studimet. Bazuar në specifikat e lëndëve (ndarja në planin mësimor të programit të studimit) përcaktohet dhe pesha e vlersimit gjatë provimit final. Duke qënë se ky program

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

48

	studimi ka vetëm një vit që është i hapur studentët bazuar në rezultatet e tyre ishin në pritje të merrnin pjesë në procedurën e realizimit të provimit final.						
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Në UMSH në përgjithësi studentët i nënshtrohen provimit përmbyllës për përfundimin e studimeve përveç rasteve të vecanta kur studentët kanë rezultate të larta dhe kanë interes për paraqitjen e një punimi apo teme diplome. Gjatë takimit me stafin akademik u vu re angazhimi i stafit për nxitjen e studentëve që të punojnë me studime apo tema diplomash. <i>Evidenca:</i> Evidenca 27. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.						
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Kjo pikë nuk aplikohet për këtë program studimi duke qënë se këta studente nuk angazhohen në kërkime shkencore.						
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në evidencën nr.27 udhëheqësi ka për detyrë asistimin e studentit në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre si dhe shkrimin e temës së diplomës sipas formatit të duhur. Në këtë program studimi mbrojtja e temave të diplomës nuk është aplikuar deri më tani. <i>Evidenca:</i> Evidenca 27. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës						
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kontaton se në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. <i>Evidenca:</i> Evidenca 5. Rregullore e FSHPS Evidenca 17. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit						
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset sipas procedurave ligjore me diplomën dhe suplementin përkatës të miratuar në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë. Gjithashtu i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>Evidenca:</i> Evidenca 30. Model Diplome Evidenca 31. Suplement Diplome						
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.							
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore ruan dhe arkivon për një periudhë të pacaktuar kohe dosjet e studentëve. Ky arkivim bëhet në hard dhe soft copy. Nuk është vënë në dispozicion të GVJ-së një dokumentacion mbështetës për këtë pikë.						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet përfundim</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet përfundim	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet përfundim	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
		X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT



Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në vizitën në IAL UMSH, si dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion (Rregullore e UMSH), GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNj) është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të IAL UMSH, të dhëna të cilat përfshijnë personelin akademik efektiv, atë me kontratë dhe atë administrativ, dhe të cilat mblidhen dhe administrohen në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë në fuqi. Gjatë vizitës në IAL UMSH, në takimim me stafin e zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi që kjo zyrë i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar, si dhe një pjesë të tyre në formë elektronike. GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme, dosje të cilat përmbanin dokumentat e plota të personelit, të tilla si: CV, dokumentin e identifikimit, pozicionin e punës, diplomat, gradat dhe titujt shkencorë, kontratën e punës, dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve, etj.</p> <p>GVJ konstaton se informacioni për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik mbahet nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë përgjegjës për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektësh (të dhënat që kanë të bëjnë me programet e lëndës në të cilën stafi akademik është angazhuar në program, aplikimi për projekte, mobilitete etj. Të dhëna ruhen dhe në sekretarinë e fakultetit, që kanë të bëjnë me procesin mësimor të ndjekur prej stafit akademik të angazhuar në programin e studimit si: procesverbale, dosjet e studentëve me dokumentacionin e regjistrimit, praktika mësimore, diploma etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> 4. RREGULLORE E UMSH 7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP Takimi në IAL UMSH me përfaqësuesin e zyrës së Burimeve Njerëzore</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë</p>	<p>GVJ konstaton se IAL UMSH i harton procedurat e rekrutimit të</p>

<p>harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>personelit akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH’ dhe mbështetur në dokumentat e brendshme të institucionit: Rregullore e UMSH, ku Kreu V, nenet 38-39 japin informacion mbi punësimin e personelit akademik dhe procedurat e rekrutimit & angazhimit. Sipas Përmbledhjes së Procedurës së rekrutimit, synohet punësimi me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent dhe objektiv.</p> <p>Në takimin e GVJ me drejtues të Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ata shprehën që marrin të gjitha masat që në procesin e rekrutimit të punësohen ekspertë që i përshtaten programeve të ofruara të studimit, dhe në përzgjedhjen e kandidatit në mënyrë specifike vlerësohen edukimi & kualifikimi, kërkimi shkencor dhe eksperiencia profesionale.</p> <p>Të gjithat të dhënat mbi rekrutimin e personelit akademik disponohen sipas dosjeve përkatëse në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila i bën ato publike. Kriteret përcaktohen nga njësitë bazë, në rastin konkret nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, të cilat i parashtrohen Dekanit, dhe ky i fundit më pas ia propozon për miratim Rektorit; më pas bëhet shpallje publike për vendin e lirë dhe ngrihet komision vlerësimi Ad-Hoc që ndjek procedurën deri në fund bashkë me përfaqësuesin e zyrës së BNj. Konkurimi është i hapur dhe shpallja publikohet për çdo semestër në faqen zyrtare të internetit të IAL UMSH, në rrjetet sociale, si dhe në raste të caktuara në shtyp dhe televizion.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ u njoh me këto procedura nëpërmjet përfaqësuesit të zyrës së Burimeve Njerëzore si dhe në takimin me personelin dhe drejtuesit e IAL, dhe konstatoi se këto procedura janë të hapura dhe transparente.</p> <p><i>Evidenca:</i> 4. RREGULLORE E UMSH; nenet 38-39 32. PERMBLEDHJE E PROCEDURES SE REKRUTIMIT Linku: https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise Linku: https://www.umsh.edu.al/d/277/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise Takimi në IAL UMSH me përfaqësuesin e zyrës së Burimeve Njerëzore</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore</p>	<p>IAL UMSH, për çdo semestër publikon nevojat, kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi dhe rekrutimi i kandidatave reflektojnë përputhshmërinë mes profilit të kërkuar dhe aftësive të manifestuara</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


51

<p>dhe i bën ato publike.</p>	<p>nga aplikuesi. GVJ konstaton që kërkesat për personel akademik vijnë nga njësitë bazë, dhe konkretisht në rastin konkret nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, bazuar tek planet mësimore dhe ngarkesa mësimore, të cilat i përcillen Dekanit, dhe më pas Rektorit për miratim. Kriteret specifike/të posaçme për personelin akademik për këtë program studimi përcaktohen nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë me miratim të Dekanit. Rektori ngre një komision të kryesuar nga Dekani i fakultetit përkatës për të realizuar procedurën e përzgjedhjes e cila kalon në dy faza:</p> <p>a) Paraqitja nga ana e kandidatit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës pranë ZBNj, ku kjo e fundit ia përcjell komisionit të ngritur nga Rektori; komisioni bën vlerësimin paraprak të kërkesave të paraqitura nga kandidatët, dhe</p> <p>b) Bëhet intervistimi i kandidatëve dhe hartohet raporti nga ana e komisionit, dhe i dërgohet për miratim Rektorit.</p> <p>Kriteret kanë bazë kualifikimet akademike dhe eksperiencën e punës në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë dhe fushën specifike sipas lëndëve të programit të studimit. Procesi i rekrutimit realizohet me procedurë të konkurimit të hapur publik, në një proces transparent dhe objektiv; më pas Komisioni analizon kandidaturat, i interviston, dhe procedura vijon me listimin e kandidaturave sipas vlerësimit që japin anëtarët e komisionit. Punesimi bëhet pas shkresës së miratimit të Rektorit.</p> <p>Një procedurë normale e publikuar punësimi për staf akademik përmban këto specifitime: përshkrimin e institucionit dhe fushave të studimit, njësinë bazë që hap pozicionin, pozicionet e lira, kualifikimet e kërkuara, dokumentacionin e aplikimit (letër interesi, CV), etj. Njoftimet për vendet e lira shpallen në faqen e web-it të IAL (www.umsh.edu.al), në rrjetet sociale, në raste të caktuara në shtyp dhe televizion, njoftime të cilat përmbajnë kërkesat e përgjithshme dhe specifike, përkatëse sipas vendeve të lira të shpallura.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>4. RREGULLORE E UMSH; nenet 38-39 32. PERMBLEDHJE E PROCEDURES SE REKRUTIMIT 7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP Takimi në IAL UMSH me përfaqësuesin e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe me drejtues të UMSH</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të</p>	<p>IAL UMSH i zhvillon procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel në përputhje legjislativ në fuqi, me dokumentat: Rregullore e UMSH, si dhe përcaktimet në Statutin e UMSH. Për të gjitha kategoritë e rekrutimit të stafit ngrihen komisione ad-hoc nga Rektori të kryesuar nga Dekani i fakultetit</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



52




<p>kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>përkatës për të realizuar procedurën e përzgjedhjes, por shumica e anëtarëve të komisionit është nga njësia bazë (rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit caktohen në aktet e brendshme të IAL). Njoftimet për vendet e lira shpallen në faqen e web-it të IAL, në rrjetet sociale, në raste të caktuara në shtyp dhe televizion, njoftime të cilat përmbajnë kërkesat e përgjithshme dhe specifike, përkatëse sipas vendeve të lira të shpallura. Procedura e përzgjedhjes kalon në dy faza: a) Paraqitja nga ana e kandidatit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës pranë ZBNj, ku kjo e fundit ia përcjell komisionit të ngritur nga Rektori; komisioni bën vlerësimin paraprak të kërkesave të paraqitura nga kandidatët, dhe b) Bëhet intervistimi i kandidatëve dhe hartohet raporti nga ana e komisionit, dhe i dërgohet për miratim Rektorit. Vlerësimi final i çdo kandidati përbëhet nga pikët e dosjes dhe pikët nga intervista, ku në fund kandidatët renditen nga ai me pikët më të larta te ai më pikët më të ulëta.</p> <p>Sipas drejtuesve të IAL UMSH, kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi dhe rekrutimi i kandidaturave reflektojnë përputhshmërinë mes profilit të kërkuar dhe aftësive të manifestuara nga aplikuesi (elementë të tjerë që merren në konsideratë në procesin e vlerësimit të kandidatëve janë edhe kriteret specifike, si përvoja e punësimit; rezultatet personale të kandidatit; aktiviteti kërkimor dhe botues; aftësitë komunikuese, etj).</p> <p>Gjatë vizitës në IAL UMSH, GVJ u njoh me disa dosje të procedurave të rekrutimit të personelit pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, dhe konstatoi se këto procedura janë ndjekur për të gjithë stafin e rekrutuar.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>1. STATUTI I UMSH 4. RREGULLORE E UMSH; nenet 38-39 32. PERMBLEDHJE E PROCEDURES SE REKRUTIMIT 7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP</p> <p>Takimi në IAL UMSH me përfaqësuesin e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe me drejtues të UMSH</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për</p>	<p>Sipas drejtuesve të IAL UMSH, kjo IAL përpiqet të krijojë mjedis</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>infrastrukturor dhe kushte pune të barabarta dhe nxitëse për stafin e saj akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ, me synim krijimin e një mjedisi tërheqës dhe të përshtatshëm për komunitetin e universitetit. Nga vizita e GVJ në vend ajo u njoh me mjediset dhe kushtet e punës për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në IAL UMSH, nga ku konstatohet se mjediset ku zhvillohen aktivitetet mësimore të këtij programi studimi kanë një infrastrukturë të përshtatshme dhe funksionale, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Këto mjedise janë të tilla që ofrojnë kushte të mira pune dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave profesionale të personelit të IAL UMSH. Mjediset që lidhen me procesin mësimor janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit, si kompjutera, projektorë, etj., si dhe mbulohen nga rrjeti ëireless që ofron internet për stafin dhe studentët. Stafi akademik dhe studentët kanë akses në bibliotekën fizike të IAL UMSH si dhe atë online për t'ju ardhur në ndihmë atyre për ecurinë normale të procesit mësimor dhe atë kërkimor shkencor.</p> <p><i>Evidenca:</i> 5. RREGULLORE FSHSP 10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP 3. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit në IAL UMSH me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, GVJ u informua se IAL UMSH ofron angazhimin e tij për t'i dhënë mundësi stafit akademik që të kenë një kualifikim dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm, objektiv i cili shprehet edhe në Strategjinë e Zhvillimit të UMSH. IAL UMSH mbështet pjesëmarrjen e personelit në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. GVJ konstaton gjithashtu se UMSH përpiqet të mbështesë personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore jashtë vendit, ku aplikimi i tyre për këto fonde shihet rast pas rasti me komision ad-hoc.</p> <p><i>Nga GVJ sugjerohet që të caktohet me vendim një fond i caktuar për financimin e botimeve të pedagogëve për çdo vitin akademik, pra duhet theksuar që duhet më shumë angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> 3. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e</p>	<p>Në takimin me personelin akademik, me përgjegjësen e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.fscal.al

54

<p>përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimitor-shkencor.</p>	<p>Dekani e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, GVJ u informua që IAL UMSH nxit dhe mbështet zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies si dhe përdorimin e teknologjive të reja. Kjo mbështetje konsiston jo vetëm në ofrimin e mundësive për mobilitete dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore me partnerë të huaj të stafit akademik, por edhe në ofrimin e trajnimeve në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Konkretisht gjatë vitit akademik 2020-2021 janë bërë trajnime për stafin për kërkimin shkencor, për përdorimin e sistemit SMS (sistemi për hedhjen e notave, frekuentimin e studentëve, etj) nga ana e stafit akademik, për përmirësimin e sistemit mësimitor, etj. Gjatë kohës së pandemisë, në kushtet e zhvillimit të mësimit online, personeli akademik dhe studentët u trajnuan për përdorimin e platformës Google Classroom, Google Meet, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> 22. PROGRAM I TRAJNIMEVE 2020-2021 19. UDHEZUES MBI PËRDORIMIN E PLATFORMAVE TE MESIMIT ONLINE</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në IAL UMSH, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike si dhe Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, dëshmojnë një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin (VKM nr.418, 10.05.2017 – Për standardet, kriteret, dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e IAL dhe të degëve të tyre; dhe nivelin e kualifikimit të stafit).</p> <p>Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh janë angazhuar 7 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 0 pedagogë me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat e personelit akademik (PAE dhe PAK) që mbulojnë këtë program studimi janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 pedagog me titullin Prof. Dr. - 1 pedagog me titullin Prof. Asoc. Dr. - 5 pedagogë me titullin Dr/PhD <p>Titujt dhe gradat e personelit akademik (PAE dhe PAK) që janë pjesë e Departamentit të Administratës Publike dhe Formimit Bazë janë si më poshtë: 1 pedagog me titullin Prof. Asoc. Dr.; 4 pedagogë me titullin Dr/PhD; 3 pedagogë me Master Shkencor (ku njëri është PAK).</p> <p>Në bazë të dokumentave të dorëzuara, personeli akademik efektiv</p>





	mbulon 100% të programit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh.		
	<i>Evidenca:</i>		
	4. RREGULLORE E UMSH		
	10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e IAL UMSH dhe konstatoi, bazuar edhe tek dokumentacioni mbështetës, se institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në një ambient (të vetin sipas RVB ... i pozicionuar në Bulevardin Gjergj Fishta, Tiranë), që ofron një infrastrukturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme (lidhur me hapësirën, akustikën, temperaturën, ndriçimin, lagështirën, etj) për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM nr.418, datë 10.05.2017.</p> <p>Në mjediset (godina me 5 kate) e UMSH gjenden sallat/auditorët e leksioneve, të seminareve, laboratorit i informatikës, një sallë konferencash dhe biblioteka.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>24. RELACION I VERIFIKIMIT TE GODINES</p> <p>10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në bazë të vizitës në mjediset e IAL UMSH dhe dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se klasat/auditorët janë të pajisura me kompjuter (për pedagogun) dhe videoprojektor, dhe me lidhje interneti ëi-fi që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Për qëllime të organizimit të aktiviteteve shkencore të tilla si konferenca, seminare, leksione të hapura, etj, aktivitete sociale apo kulturore, mund të shfrytëzohet salla e konferencave. Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më mirë të procesit mësimor (instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i IT), ku instalimet e programeve të reja bëhen në kohë reale në bazë të kërkesave të pedagogëve.</p>

	<p><i>Evidenca:</i> 24. RELACION I VERIFIKIMIT TE GODINES 10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 3. Labororët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>IAL UMSH disponon 3 laboratorë informatike (me sipërfaqe 144 m²) të pajisur me PC për çdo student, ku studentët përdorin programe specifike profesionale sipas lëndëve që zhvillojnë. E gjithë infrastruktura e rrjetit kompjuterik mirëmbahet nga stafi i IT, i cili mundëson monitorimin dhe sigurinë fizike të pajisjeve informatike. Aktualisht, 16 studentë po ndjekin (në vitin e parë) programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, kështu që është lehtësisht e menaxhueshme pjesa e nevojës për përdorimin e laboratorëve.</p> <p>IAL UMSH i kushton rëndësi teknologjisë, cilësisë së laboratorëve, por edhe programeve kompjuterike, të cilat shfrytëzohen për module apo lëndë të ndryshme (lëndët/modulet që kërkojnë realizimin e projekteve dhe detyrave nga ana e studentit, mund të shfrytëzojnë laboratorët si dhe programet e instaluar në këto laboratorë për realizimin e këtyre projekteve dhe detyrave).</p> <p>GVJ konkludon se mjediset mësimore (klasat/auditoret, laboratorët, salla e konferencave, biblioteka, etj) të IAL UMSH janë në mbështetje të plotë të realizimit të objektivave të programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh.</p> <p><i>Evidenca:</i> 24. RELACION I VERIFIKIMIT TE GODINES 10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>IAL UMSH disponon 3 laboratorë informatike me sipërfaqe 144 m² të pajisur me PC për çdo student, ku studentët përdorin programe specifike profesionale sipas lëndëve që zhvillojnë. Programet e instaluar përfshijnë ato Alpha, Financa 5, SPSS, Business English, etj. Të gjithë laboratorët e teknologjisë së informacionit janë në dispozicion të studentëve për tu shfrytëzuar brenda orareve të mësimin, por edhe jashtë orarit të mësimin për realizimin e detyrave të kursit, projekteve të ndryshme apo punimet e diplomës. E gjithë infrastruktura e rrjetit kompjuterik mirëmbahet nga stafi i departamentit të IT, i cili mundëson monitorimin dhe sigurinë fizike të pajisjeve informatike.</p> <p><i>Evidenca:</i> 24. RELACION I VERIFIKIMIT TE GODINES 10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të porsaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Nga informacioni që GVJ mori në takimin me Përgjegjësen e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë si dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, sipas tyre, IAL UMSH ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit publik dhe privat, me institucione të pavarura,</p>





profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>si dhe me pushtetin lokal, të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Sipas planit mësimor të programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh, praktika profesionale/mësimore është 150 orë, ku studenti i realizon pranë institucioneve me të cilat IAL UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe disa orë mund të përdoren gjithashtu edhe në ambientet e IAL UMSH. Gjithashtu, në dokumentin Udhëzues për Praktikën, jepet një informacion mbi gjithë procesin që ka lidhje me zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve (të drejtat dhe detyrimet e tyre, frekuentimi, dokumentat për tu plotësuar, vlerësimi, etj) pranë institucioneve publike e private, etj.</p> <p>GVJ konstaton se IAL UMSH i ofron studentëve të gjitha mundësitë për të realizuar praktika profesionale në përputhje me standardet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>28. UDHEZUES PER PRAKTIKAT</p> <p>13. FORMULARET DHE RAPORTI STANDART I PRAKTIKES (F.14-F.17)</p> <p>10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP RVB e IAL UMSH</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>GVJ vizitoi bibliotekën e IAL UMSH, të vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional. Biblioteka, si njësi ndihmëse ushtron aktivitetin e saj brenda hapësirës së IAL UMSH, e cila ofron mundësi aksesit për të gjithë studentët dhe stafin. Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj, paradite ose mbasdite nga dita e Hënë në të Premte, dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo rezervimeve të studentëve. Sipas drejtuesve të IAL UMSH, studentët kanë të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të përdorimit të një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online/virtuale: Elgar dhe Cobiss (Elgar online sipas punonjësve të bibliotekës aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL UMSH), e cila iu vjen në ndihmë atyre për ecurinë normale të procesit mësimor dhe atë të punës shkencore.</p>





	<p>Biblioteka ka një fond të pasur me libra në fusha të ndryshme të interesit të IAL UMSH, duke përfshirë dhe literaturën përkatëse për programin e studimit MP Hartim, Menaxhim Projektsh, koleksion i cili pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me tituj të ndryshëm me kalimin e kohës. Nga diskutimi me punonjësen e bibliotekës, vërehet se titujt janë zgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit administrativ dhe akademik.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>13'. Lista e titujve në bibliotekën Fizike dhe Online për këtë program studimi</p> <p>25. KERKESE PER LIBRA DAPFB</p> <p>25'. Marreveshjet me librari online (Cobiss)</p> <p>26'. Manuali i bibliotekes online</p> <p>10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj një mori titujsh në gjuhën shqipe dhe mjaft tituj në gjuhë të huaj, ku një pjesë e librave fizikë janë të dedikuara për fushën e ekonomisë, si dhe një numër të konsiderueshëm revistash, cikël leksionesh dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve. Përveç bibliotekës fizike, ekziston dhe biblioteka virtuale: Elgar dhe Cobiss (Elgar online sipas punonjësve të bibliotekës aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL UMSH).</p> <p>Në takimin me përgjegjësen e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë dhe punonjësen e bibliotekës, konstatohet që në fund të vitit akademik, biblioteka bashkëpunon me departamentin dhe dërgon një formular për kërkesë librash për të gjithë personelin e departamentit, duke i lejuar stafit akademik që të japin informacione në lidhje me titujt që ata mendojnë se duhen patur e të jenë në gjendje në bibliotekë për vitin e ardhshëm akademik. Pas krijimit të listës së materialeve akademike të kërkuar nga pedagogët, Dekani i dërgon Administratorit të UMSH kërkesën për librat përkatës, dhe më pas fillohen blerjet duke u siguruar që titujt e duhur të jenë në kohën e duhur për stafin akademik dhe studentët e IAL UMSH.</p> <p><i>Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se IAL UMSH ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave për të mbështetur nevojat e programit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>13'. Lista e titujve në bibliotekën Fizike dhe Online për këtë program studimi</p> <p>25. KERKESE PER LIBRA DAPFB</p> <p>25'. Marreveshjet me librari online (Cobiss)</p> <p>26'. Manuali i bibliotekes online</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p> <p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës së IAL UMSH, si dhe mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar & takimi me studentët, GVJ u informua nga punonjësja e bibliotekës që institucioni ka zgjedhur të bëjë abonimin në bibliotekat online/virtuale si me Elgar & Cobiss, etj (Elgar online sipas punonjësve të bibliotekës aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL UMSH), në mënyrë që dhe shërbimi të jetë në përputhje me nevojat që kërkon stafi dhe studentët, si dhe u konstatua që kushtet për akses janë të barabarta e pa pagesë për studentët në aksesimin e bibliotekës on-line.</p> <p>Shërbimi bibliotekar kryhet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga IAL UMSH dhe ofrohet për studentët & stafin akademik të fakultetit. Biblioteka ka një kapacitet prej 30 vendesh, ku 6 vende janë me përdorim kompjuteri dhe interneti. Oraret që biblioteka qëndron e hapur për studentët dhe stafin është në ditët: E Hënë – E Premte. Përveç aksesimit të bibliotekës online në ambientet e bibliotekës së IAL UMSH, studentët dhe stafi mund të shfletojnë materialet e bibliotekës në një sallë leximi komode, të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>13'. Lista e titujve në bibliotekën Fizike dhe Online për këtë program studimi</p> <p>25. KERKESE PER LIBRA DAPFB</p> <p>25'. Marreveshjet me librari online (Cobiss)</p> <p>26'. Manuali i bibliotekës online</p> <p>10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e IAL UMSH ka një kapacitet prej 30 vendesh, ku 6 vende janë me përdorim kompjuteri dhe interneti pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve (ajo qëndron e hapur për studentët & stafin në ditët: E Hënë – E Premte). Biblioteka Elgar online aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL UMSH (sipas punonjësve të bibliotekës).</p> <p>Stafi i bibliotekës është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik në çdo moment për të lehtësuar procesin e gjetjes së librave apo revistave të caktuara dhe për t'ju ardhur në ndihmë për pyetje potenciale (për lehtësi është krijuar dhe Manuali i Bibliotekës Online).</p> <p><i>Megjithatë GVJ konstaton se numri i kompjuterave/laptopëve është i vogël dhe sugjeron shtimin e tyre në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>13'. Lista e titujve në bibliotekën Fizike dhe Online për këtë program</p>

	<p>studimi</p> <p>25. KERKESE PER LIBRA DAPFB</p> <p>25'. Marreveshjet me librari online (Cobiss)</p> <p>26'. Manuali i bibliotekes online</p> <p>10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në IAL UMSH, GVJ u informua që UMSH parashikon fonde çdo vit për shtimin e literaturës në bibliotekë (për të plotësuar në këtë mënyrë bibliotekën fizike). Vitet e fundit institucioni ka bërë përpjekje maksimale që t'i japë rëndësi bibliotekës online/virtuale, kjo dhe për shkak të pandemisë dhe pamundësisë së studentëve për të shfrytëzuar literaturën në ambientet e institucionit. Nga takimi i GVJ me përgjegjësen e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë dhe punonjësen e bibliotekës, konstatohet që në fund të vitit akademik, biblioteka bashkëpunon me departamentin dhe dërgon një formular për kërkesë librash për të gjithë personelin e departamentit, duke i lejuar stafit akademik që të japin informacione në lidhje me titujt që ata mendojnë se duhen patur e të jenë në gjendje në bibliotekë për vitin e ardhshëm akademik. Pas krijimit të listës së materialeve akademike të kërkuar nga pedagogët, Dekani i dërgon Administratorit të UMSH kërkesën për librat përkatës, dhe më pas fillohen blerjet duke u siguruar që titujt e duhur të jenë në kohën e duhur për stafin akademik dhe studentët e IAL UMSH. Një pjesë e titujve të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës janë botime të personelit akademik të IAL UMSH, si tekste mësimore dhe libra të tjerë, dhuratë nga pedagogët e lëndëve ose botime të UMSH Press.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>25. KERKESE PER LIBRA DAPFB</p> <p>13'. Lista e titujve në bibliotekën Fizike dhe Online për këtë program studimi</p> <p>25'. Marreveshjet me librari online (Cobiss)</p> <p>26'. Manuali i bibliotekes online</p> <p>10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në bibliotekën e IAL UMSH dhe nga takimi me studentët, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve në ditët: E Hënë – E Premte. GVJ gjykon që orari është i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e interesuar duke qenë në një hapësirë të gjerë orari (paradite, drekë dhe pasdite), pa cënuar orarin e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>13'. Lista e titujve në bibliotekën Fizike dhe Online për këtë program studimi</p> <p>25. KERKESE PER LIBRA DAPFB</p>




	25 ^o . Marreveshjet me librari online (Cobiss) 26 ^o . Manuali i bibliotekes online Takimi me punonjësit e bibliotekës të IAL UMSH		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.

IAL UMSH ka një sistem menaxhimi të njohur ndryshe si SMS UMSH (i cili përmirësohet nga viti në vit, duke i shtuar module dhe funksione të reja) përmes të cilit organizohen dhe administrohen të gjitha proceset mësimore të fakulteteve dhe të programeve që ata ofrojnë, sistem i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i institucionit (nëpërmjet një username dhe fjalëkalimi të mundësuar nga stafi i IT).

Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore të IAL UMSH, GVJ u informua se informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim administrohet nga Sekretaria Mësimore. Sekretaria mësimore administrohet gjithë informacionin që lidhet me studentët, të dhënat personale të tyre, notat, etj, në formën e regjistrave fizikë dhe në mënyrë elektronike. GVJ u njoh me regjistrat gjatë vizitës në IAL UMSH dhe dosjet personale të studentëve, dhe zgjodhi në mënyrë të rastësishme disa emra studentësh të programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh (aktualisht 16 studentë që ndjekin vitin e parë të studimeve) dhe konstatoi që të dhënat e tyre në dosje, notat në regjistër dhe procesverbale, numrat e matrikullimit, etj, ishin pasqyruar korrekt nga ana e sekretarisë mësimore.

GVJ sugjeron që duhej miratuar dhe paraqitur dhe një Rregullore e Sekretarisë Mësimore!

Evidenca:

- 4. RREGULLORE E UMSH
- 5. RREGULLORE E FSHSP
- 26. UDHEZUES I PERDORIMIT TE SISTEMIT SMS
- Vizita e GVJ në zyrën e sekretarisë mësimore

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik,

Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, zyra e Burimeve Njerëzore, është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të IAL UMSH, zyrë e cila i mban të dhënat e personelit akademik, atij ndihmës akademik, dhe personelit


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

62

<p>personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>administrativ & partnerëve të angazhuar në realizimin e programit në dosje personale në format të printuar. Dosjet e personelit përditësohen periodikisht dhe në to gjenden këto dokumenta të tilla si CV-të e personelit (për personelin akademik ajo shoqërohet me fotokopje të artikujve dhe botimeve shkencore); pozicioni i punës; diplomat & gradat/titujt shkencorë; fotokopje të dokumentit të identifikimit dhe adresës së vendbanimit; formular vetëdeklarimi apo dëshmi penaliteti; kualifikime të tjera / informacione shtesë, etj. Sistemi SMS UMSH në varësi të aksesit përdoret prej stafit administrativ (si sekretaritë e fakulteteve), studentëve dhe stafit akademik & ndihmës akademik. Secila kategori përdoruesish akseson vetëm panelin e vet pa pasur qasje të tjera, pra aksesit është i kufizuar, individual dhe i personifikuar. Stafi i IT-së vendos në shërbim të stafit akademik & ndihmës akademik, dhe atij administrativ të institucionit një adresë të personalizuar me emrin dhe mbiemrin e tyre, në mënyrë që të identifikohen në sistemin online. Ndërveprimi mes stafit dhe studentëve zhvillohet përmes komunikimit me e-mail dhe mund të përdorin gjithashtu Bibliotekën online (krahas asaj fizike), Sistemin e Menaxhimit, etj. Nëpërmjet sistemit SMS UMSH i mundësohet stafit akademik dhe sekretarive mësimore të hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve, programeve përkatëse ku bëjnë pjesë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që duhej miratuar dhe paraqitur dhe një Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore!</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>4. RREGULLORE E UMSH 5. RREGULLORE E FSHSP 26. UDHEZUES I PERDORIMIT TE SISTEMIT SMS</p> <p>Takimi në IAL UMSH me përfaqësuesin e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe me përfaqësues të sekretarisë mësimore RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Aksesit tek informacioni dhe dokumentacioni për gjithë personelin dhe studentët bëhet duke ruajtur privatësinë. Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL UMSH, si dhe të aksesojnë sistemin SMS UMSH (informacioni është i dedikuar dhe personal dhe aksesit ka kufizime për secilin përdorues sipas kategorisë që i përket: staf administrativ, student apo pedagog) me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. stafi akademik iu jep akses online studentëve në dokumenta të tilla si: të kontrollojnë informacione rreth tyre, mbi syllabuset e lëndëve, materialet mësimore, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, rezultatet për lëndët që ndjekin, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi pedagog-student. Çdo student mund të shikojë të dhënat personale të tij, por nuk ka akses në ndryshimin e rezultateve akademike. Sistemi, ashtu siç</p>




	<p>ofron një shërbim të madh për stafin dhe studentët, njëkohësisht gjeneron dhe të dhëna mbi numrin e tyre, frekuentimet, programin ku janë regjistruar, notat, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> Takimi në IAL UMSH me drejtues të IAL UMSH RVB e IAL UMSH 26. UDHEZUES I PERDORIMIT TE SISTEMIT SMS</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët dhe mund të aksesojnë faqen web të IAL UMSH (www.umsh.edu.al), si dhe të aksesojnë sistemin SMS UMSH (të drejtën për të aksesuar në këtë sistem e kanë të gjithë ata përdorues që janë të pajisur me një adresë zyrtare nga IAL) me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. stafi akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore të uploaduara, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi interaktive pedagog-student dhe për të shkëmbyer informacion ndërmjet personelit dhe studentëve. Stafi akademik mund të ngarkojë leksionet dhe materialet mësimore, si dhe ka forum për të zhvilluar diskutime pedagog-student lidhur me çështje të caktuara të lëndës/modulit.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët përdorin gjithashtu dhe platformat si Google Classroom & Google Meet si forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i> Faqja web e IAL UMSH: www.umsh.edu.al Linku: http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar 26. UDHEZUES I PERDORIMIT TE SISTEMIT SMS</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nëpërmjet faqes web të IAL dhe sistemit SMS UMSH mund të shkëmbehet informacion midis pedagogëve dhe studentëve, si dhe aksesim nga studentët për të gjithë materialin që lidhet me procesin mësimor. Sistemi i menaxhimit SMS UMSH garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Gjithashtu, komunikimi ndërmjet të gjithë palëve në proces në UMSH realizohet nëpërmjet postës elektronike me adresat e email-it të domain-it: www.umsh.edu.al. Përveç faqes së web-it të UMSH, formë tjetër komunikimi janë edhe platformat e ndryshme të rrjeteve sociale, nëpërmjet të cilave bëhet komunikimi jo vetëm midis stafit dhe studentëve, por edhe shpërndahet informacion për palët e treta të interesuara për programet e studimit në IAL UMSH.</p> <p><i>Evidenca:</i> Faqja web e IAL UMSH: www.umsh.edu.al</p>

64

	<p>Linku: http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Takimi në IAL UMSH 26. UDHEZUES I PERDORIMIT TE SISTEMIT SMS</p>						
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Nga GVJ konstatohet që informacionet që lidhen me programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, me stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimin e bursave të studimit, informacionin mbi aktivitetet e ndryshme & informacione të tjera që lidhen me IAL UMSH, gjenden dhe në faqen e web-it https://www.umsh.edu.al, të cilat publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze. Ndërkohë, në faqen web ndodhet një seksion i veçantë për studentët, ku gjenden informacione për këshillin studentor, klubet studentore, këshillimin e karrierës, jetën studentore, alumnin, orarin mësimor, kalendarin akademik, procesin e diplomimit, udhëzime, etj. Përveç faqes së web-it, IAL UMSH i publikon informacionet e veta dhe i ndan me publikun edhe në kanale të tjera të informimit dhe median sociale.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi. Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it Faqja web: www.umsh.edu.al</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, GVJ konstaton se IAL UMSH jep të dhëna financiare të kostove në nivel institucional, ku pasqyrohen të ardhurat (nga fee-të e studentëve, nga projektet, dhe nga burime të tjera) dhe shpenzimet (operative, administrative, për investime, për kërkim shkencor, etj). Gjithashtu përgatitet buxheti nga administratori në përputhje me parashikimet ligjore, Statutin dhe Rregulloret e UMSH. Departamentet e IAL UMSH paraqesin kërkesat e tyre për vitin e ri akademik, të cilat pas miratimit në nivelet përkatëse përcillen në zyrën e financës i cili bën unifikimin e tyre brenda buxhetit të IAL si një njësi e vetme.</p> <p><i>GVJ sugjeron që duhej një raport më i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi.</i></p>

	<p><i>Evidenca:</i> 18. TE DHENA FINANCIARE INSTITUCIONALE 5'. Raporti Auditi të jashtëm</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit përmban zëra të tillë si financimi i burimeve njerëzore, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzimet për paga, shpenzimet për kërkim shkencor, shpenzimet për investime, si dhe shpenzime të tjera. Nga drejtuesit e IAL UMSH është vënë si objektiv rritja e të ardhurave nga projektet e ndryshme.</p> <p><i>Nga GVJ sugjerohet që duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vete!).</i></p> <p><i>Evidenca:</i> 18. TE DHENA FINANCIARE INSTITUCIONALE 5'. Raporti Auditi të jashtëm</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>IAL UMSH kryen auditim financiar të jashtëm të pavarur çdo vit. Raporti i lëshuar nga auditimi i pavarur paraqet opinionin e tij në lidhje me të gjitha aspektet materiale, pozicionin dhe performancën financiare, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi. Pjesa financiare është e rëndësishme për të gjithë grupet e interesit: pedagogë, studentë, staf ndihmës akademik dhe staf administrativ.</p> <p><i>Evidenca:</i> 5'. Raporti Auditi të jashtëm 18. TE DHENA FINANCIARE INSTITUCIONALE</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, <i>GVJ konstaton se UMSH dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, dhe jo të detajuara në nivel fakulteti dhe departamenti, apo për programin specifik të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh.</i> Sipas drejtuesve të IAL UMSH, në bazë rezultateve të raporteve paraardhëse të hartuara nga Zyra e Financës dhe Administratori, parashikohen ndërhyrje në buxhetin pasardhës që miratohet nga struktura përkatëse, duke plotësuar nevojat apo kërkesat që vijnë nga departamentet apo njësitë kryesore.</p> <p><i>Evidenca:</i> 5'. Raporti Auditi të jashtëm 18. TE DHENA FINANCIARE INSTITUCIONALE 4. RREGULLORE E UMSH</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesit e IAL UMSH, ata shprehen</p>

duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	entuziastë për ecurinë e institucionit kjo bazuar në qëndrueshmërinë dhe mjaftueshmërinë financiare të IAL. Pjesa financiare është e rëndësishme për të gjithë grupet e interesit: pedagogë, studentë, staf ndihmës akademik dhe staf administrativ.		
	<i>Evidenca:</i> 5'. Raporti Auditi të jashtëm 18. TE DHENA FINANCIARE INSTITUCIONALE 10. PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP RVB e IAL UMSH		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se IAL UMSH ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me Statutin e IAL UMSH, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, Rregulloren e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, Rregulloren e programit të studimit MP Hartim, Menaxhim Projektsh, si dhe në përputhje me me ligjin nr.80/2015, udhëzimin e MASR, nr.10, datë 15.05.2019, si edhe Udhëzimin e MASR, nr.17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve master. Gjithashtu, diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit MP Hartim, Menaxhim Projektsh.
	<i>Evidenca:</i> 5. RREGULLORE E FSHSP 6. RREGULLORE E DAPFB



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

67

	<p>7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP</p> <p>27. UDHEZUES PER PERGATITJEN E PUNIMIT TE DIPLOMES</p> <p>2. PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT</p> <p>3. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP</p> <p>1. STATUTI I UMSH</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se politikat dhe procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. Kjo gjë është e përcaktuar në Statutin dhe Rregulloret e UMSH që përcaktojnë të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë studentët e regjistruar në çdo program studimi të ofruar nga IAL UMSH.</p> <p>Si vizion, UMSH ka krijimin e një institucioni cilësor të arsimit të lartë, i cili ofron vlera të vërteta qytetarie dhe profesionalizmi, dhe nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatisë qytetarë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv dhe në përputhje me interesat kombëtare, si dhe misioni i saj përfshin ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushat e shkencave ekonomike, psikologjike, sociale, juridike, politike, që realizojnë synimet profesionale brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë; zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike; ofrimin e programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik; dhe kontribuimin në mbështetje të prioriteteve dhe interesave të zhvillimit të vendit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>1. STATUTI I UMSH</p> <p>4. RREGULLORE E UMSH</p> <p>5. RREGULLORE E FSHSP</p> <p>6. RREGULLORE E DAPFB</p> <p>7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga vizita në strukturat përkatëse në IAL UMSH dhe takimin me studentët, GVJ konstaton që kriteret dhe procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar nëpërmjet kanaleve të ndryshme formale të komunikimit. IAL UMSH i shpall kriteret dhe procedurat e aplikimit, regjistrimit, pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, apo ato të transferimit të studimeve, pas miratimit të tyre në Senatit Akademik dhe aprovimit prej MASR, dhe i publikon në faqen e internetit www.umsh.edu.al (si dhe në rrjete sociale), në mënyrë që tu bëjnë me dije të interesuarve të gjitha kriteret dhe procedurat që UMSH përdor zyrtarisht për aplikimin, regjistrimin, apo transferimin nga një institucion në tjetrin.</p> <p>Në ndihmë të studentëve të IAL UMSH është edhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës & Sekretaria Mësimore & Koordinatorit i</p>



	<p>Masterit që ndihmojnë me informacione të ndryshme, si ato mbi marrëdhënien me administratën, të drejtat dhe detyrimet, udhëzime për provimet, detyrat e kursit, frekuentimin, vlerësimin, ankimimin, politikat e pranimit, transferimit, shërbimet mbështetëse, bibliotekën, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>4. RREGULLORE E UMSH 5. RREGULLORE E FSHPSP 6. RREGULLORE E DAPFB 7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 27. UDHEZUES PER PERGATITJEN E PUNIMIT TE DIPLOMES 1. STATUTI I UMSH</p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>UMSH çdo vit akademik verifikon kriteret e pranimit dhe bën renditjen e studentëve sipas këtyre kriterëve. Kriteret rishikohen nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi në bashkëpunim me fakultetin përkatës. Kriteret për pranimin e studentëve në ciklet e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh tek UMSH propozohen nga njësia kryesore dhe më pas miratohen me vendim të Senatit Akademik të UMSH, vendime të cilat i dërgohen më pas MAS, dhe një kopje elektronike ngarkohet në faqen online të UMSH, si dhe shpallen në ambientet e IAL UMSH, me qëllim informimin sa më të saktë dhe transparent të kandidatëve për studentë.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik përcaktohen kriteret e përgjithshme (si përfundimi i maturës shtetërore, me\$atarja ose ata që duan të aplikojnë për një program të dytë studimi), si dhe kriteret specifike. Kriteret e pranimit për programin MP në Hartim, Menaxhim Projektsh janë të përcaktuara në rregulloren e fakultetit dhe atë të këtij programi studimi. Aplikantët dhe grupi i targetuar i studentëve janë punonjës të institucioneve publike qendrore dhe vendore, kompanive private, organizatave jo fitimprurëse, që: vërtetojnë përfundimin e ciklit të parë të studimeve bachelor; kanë një eksperiencë pune 3-5 vjeçare në sektorë të zhvillimit apo zbatimit të projekteve; kanë të paktën një nivel B1 të gjuhës angleze; dhe plotësojnë të gjitha detyrimet ligjore sipas MAS, dhe ato kontraktuale mes tyre dhe UMSH. Përzgjedhja e studentëve bëhet mbi bazën e vlerësimit të dokumentacionit shoqërues.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>5. RREGULLORE E FSHPSP 6. RREGULLORE E DAPFB 7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 1. STATUTI I UMSH</p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet 4. RREGULLORE E UMSH</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, Fakulteti i Shkencave</p>




<p>akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Psikologjike, Sociale dhe Politike & Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë në IAL UMSH realizon takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacione nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. Në periudha të caktuara UMSH merr pjesë në panairë (ku marrin pjesë dhe IAL të tjera) të organizuara prej MAS ose në turet nëpër gjimnaze të ndryshme në vend, me synim informimin e maturantëve për mundësitë e studimit në IAL UMSH, apo organizon dhe ditët e informimit me maturantët (Ditë të Hapura) ku stafi akademik takohet me kandidatët virtualisht ose në institucion dhe u shpjegon kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit në programet që të interesuarit shfaqin interes, mundësitë e mobiliteteve, etj]. Për më shumë informacion, çdo i interesuar mund të aksesojë dhe faqen web të IAL: www.umsh.edu.al (ku jepen të dhënat për kriteret e pranimit në master, dokumentet e regjistrimit, procesin e diplomimit, etj).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>5. RREGULLORE E FSHSPSP 6. RREGULLORE E DAPFB 7. RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 1. STATUTI I UMSH Linku: https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet 4. RREGULLORE E UMSH</p>						
<p>Shkalla e përmbrshjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1099 730 1167">Përmbrshet pjesërisht</th> <th data-bbox="730 1099 948 1167">Përmbrshet kryesisht</th> <th data-bbox="948 1099 1361 1167">Përmbrshet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1167 730 1209"></td> <td data-bbox="730 1167 948 1209"></td> <td data-bbox="948 1167 1361 1209" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbrshet pjesërisht	Përmbrshet kryesisht	Përmbrshet plotësisht			X
Përmbrshet pjesërisht	Përmbrshet kryesisht	Përmbrshet plotësisht					
		X					



<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL UMSH, si dhe në takimin me studentët, GVJ konstaton që IAL UMSH informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre në lidhje me procedurat e përparimit akademik. Vlen për tu theksuar që kohëzgjatja e këtij programi studimi është 1 vit (2 semestra). Nëpërmjet sekretarisë mësimore studentët marrin informacion të rëndësishëm në lidhje me procesin mësimor, orarin, detyrimet akademike, provimet, etj. Në fillim të çdo semestri dhe për çdo lëndë/modul, pedagogët iu prezantojnë studentëve syllabueset e lëndëve, procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, etj. Gjithashtu, informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit</p>

	<p>akademik të studentëve janë të përshkruara dhe në Rregulloren e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, dhe Rregulloren e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. Në këto rregullore jepen dhe procedurat e pranimit të studentëve, ku shpjegohen kriteret e pranimit; procedurat për ankimimin; njëkohësisht informacion mbi frekuentimin e lëndëve, mungesat, vlerësimin dhe përlogaritjen e tij; informacion mbi provimet, sekretimet, të drejtat dhe përgjegjësitë që ka studenti në lidhje me institucionin, stafin akademik, studentët, administratën etj; si dhe informacion që duhet të dijë studenti për progresin akademik & informacion mbi diplomimin, etj.</p> <p>Në shërbim të studentëve për të marrë një informacion sa më të detajuar është dhe faqja web e IAL: www.umsh.edu.al, kategoria Studentët, ku jepet informacion për këshillat studentore, klubet studentore, këshillimin e karrierës, jetën studentore, alumni, orarin mësimor, kalendarin akademik, procesin e diplomimit, si dhe udhëzime të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca:</i> 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP Linku: https://www.umsh.edu.al/c/213/orari-mesimor Linku: https://www.umsh.edu.al/c/214/kalendari-akademik Linku: https://www.umsh.edu.al/c/216/udhezime</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në bazë të Statutit dhe Rregullores së programit të studimit, si dhe nga takimi me studentët, GVJ konstaton se studentëve iu vihet në dispozicion informacion i plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Studentët mund të marrin informacion për transferimin nëpërmjet faqes zyrtare të web-it të IAL UMSH, njoftimeve të publikuara në stendën e njoftimeve të institucionit dhe në rrjetet sociale. Kriteret e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit të studimit.</p> <p>Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë në bashkëpunim me struktura të tjera organizative të IAL UMSH janë të angazhuara në procesin e informimit të kandidatëve për student për të gjitha informacionet që ata janë të interesuar të dinë rreth IAL UMSH si dhe programeve të studimit ku ata duan të regjistrohen. Në rastin kur kandidati kërkon të njohë kualifikime të mëparshme, ai informohet mbi kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Pas paraqitjes së kërkesës nga studenti, ngrihet komision ad-hoc nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë për shqyrtimin e saj. Institucioni dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike pranojnë transferime sipas përcaktimeve në Rregulloren e Programit të studimit si dhe në bazë të kuotave të dorëzuara pranë MAS në fillim të vitit akademik. Studentët që kanë përfunduar studimet në një program</p>

	<p>tjetër studimi, kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e krediteve të lëndëve të njëjta ose të ngjashme, dhe kanë të drejtë të transferojnë vetëm lëndë të vlerësuara me notë përfundimtare kaluese. Në çdo rast, studenti që transferon studimet nga një shkollë tjetër në UMSH, duhet të frekuentojë aq disiplina të programit sa të fitojë një sasi të krediteve teorike të programit të studimit, si dhe praktikën dhe diplomën.</p> <p><i>Evidenca:</i> 1 – STATUTI I UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP Linku: https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në IAL UMSH dhe takimi me studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara qartë në Rregulloren e UMSH, të Fakultetit, të Departamentit, dhe Rregulloren e Programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, dokumenta të cilat janë të aksesueshme për studentët e UMSH.</p> <p>Gjithashtu, studentët informohen në fillim të çdo semestri në çdo lëndë/modul për procedurat e vlerësimit të dijeve nga pedagogët e tyre, gjatë prezantimit të lëndës dhe syllabusit përkatës. Në secilin program lëndë, pedagogët kanë përfshirë vlerësimin e studentit, peshën që zë vlerësimin sipas komponentëve si dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit, referuar tabelës së vlerësimit në rregulloren Vlerësimi i Studentit. Në javën e parë të semestrit që është edhe java e orientimit, studentët informohen prej stafit akademik dhe prej secilit pedagog për lëndën përkatëse, mbi elementët e programit të lëndës, duke përfshirë dhe vlerësimin. Edhe Sekretaria Mësimore informon studentët për çështje që kanë lidhje me sekretarinë apo çdo gjë tjetër.</p> <p><i>Evidenca:</i> 4 – RREGULLORE E UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 8 - SYLLABUSE PROGRAMI I STUDIMIT</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ kostanton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në IAL UMSH përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit. Studentët njihen gjithashtu edhe me formularin që duhet të plotësojnë për të aplikuar për zgjedhjen e temës së diplomës si dhe caktimin e pedagogut udhëheqës (atyre u shpërndahen tematikat e sugjeruara për tu zgjedhur prej tyre për diplomim, si dhe u shpjegohen procedurat e punimit të temës së diplomës dhe rregullorja</p>

	<p>përkatëse).</p> <p>IAL UMSH informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në takimet që njësitë bazë bashkë me koordinatorët zhvillojnë gjatë vitit. Informimi bëhet para se të fillojë semestri i dytë i vitit të parë (kohëzgjatja e këtij programi studimi është 1 vit) dhe zgjedhja e temës së punimit bëhet para se të fillojë periudha e praktikës profesionale. Gjithashtu në javën e orientimit (në fillim të çdo semestri) studentëve u jepen prej drejtuesve të institucionit informacione të detajuara lidhur me diplomimin. Në takimin me studentët gjatë vizitës në IAL UMSH, GVJ konstatoi se studentët kishin marrë informacionin e nevojshëm për procesin e diplomimit të tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 4 – RREGULLORE E UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB 8 - SYLLABUSE PROGRAMI I STUDIMIT 29 - UDHEZUES PER PROVIMIN E FORMIMIT 27 - UDHEZUES PER PERGATITJEN E PUNIMIT TE DIPLOMES</p>						
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarvq e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>GVJ konstaton se IAL UMSH në fillim të çdo viti akademik, në mënyrë periodike përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi/ javë të hapura me ta, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës e cila bashkëpunon me Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë (krahas departamenteve të tjera) për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh (dhe programe të tjera). Informimi i publikut bëhet me takime të drejtpërdrejta, në faqen zyrtare web, njoftimet në standat e IAL, nëpërmjet fletë palosjeve, broshurave, prospekteve, rrjeteve sociale, si dhe reklamon programet e studimit gjerësisht në media. Studentët që potencialisht mund të jenë pjesë e UMSH në të ardhmen informohen mbi programin e studimit që do të ndjekin dhe elementët kryesorë që lidhen me procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>33 – RREGULLORE E ZKSK Linku: https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 4 – RREGULLORE E UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1751 738 1825">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="738 1751 954 1825">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="954 1751 1161 1825">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1825 738 1868"></td> <td data-bbox="738 1825 954 1868"></td> <td data-bbox="954 1825 1161 1868" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>IAL UMSH siguron mundësitë që programet e studimeve që ofrohen të njihen nga studentët dhe të interesuarit duke i publikuar ato përmes fletëpalosjeve, duke i reklamuar në media, prezantuar në publik, etj. Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që informacionet në lidhje me strukturën e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, organizimin dhe kohëzgjatjen iu vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve të tyre. Gjatë vizitës në IAL UMSH, GVJ u informua se çdo vit akademik Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, krahas departamenteve të tjera, së bashku me dekanatin organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve me IAL UMSH dhe programin e studimit. Studentët marrin informacion në fillim të çdo semestri nga Sekretaria Mësimore për orarin, lëndët që do të zhvillojnë, detyrimet, strukturën e semestrit, etj. Gjithashtu, secili pedagog në prezantimin e lëndës/modulit shpjegon syllabusin, i cili përmban informacione rreth temave të përfshira, metodës së vlerësimit, aftësive që fiton studenti, etj. Informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara jepen dhe në webin zyrtar të IAL UMSH.</p> <p><i>Evidenca:</i> Linku: https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres Linku: https://www.umsh.edu.al/c/108/fakulteti-i-shkencave-psikologjike-sociale-dhe-politike 33 – RREGULLORE E ZKSK 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 4 – RREGULLORE E UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se IAL UMSH vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet/lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese (të cilat janë të përfshira tek planet mësimore dhe të bëra publike për studentët). Në bazë të dokumentave të shqyrtuara, UMSH ofron programin (i zhvilluar në gjuhën shqipe) e studimit të ciklit të dytë MP në Hartim, Menaxhim Projektsh me një kohëzgjatje 1 vit dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 60 kredite evropiane (ECTS) dhe u jepet diploma MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë. Gjithashtu, studentët mund të gjejnë informacion për lëndët/modulet dhe tek syllabuset e lëndëve/moduleve. Përveç të dhënave që studentët mund</p>


	<p>të aksesojnë në faqen web www.umsh.edu.al apo në rrjetet sociale, të gjitha rregulloret printohen në formatin hard copy për përdorim të përgjithshëm, dhe vendosen në bibliotekë nga ku studentët dhe të interesuar të tjerë mund të njihen me to dhe të lexojnë atë se çfarë u intereson atyre.</p> <p><i>Evidenca:</i> Linku: https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres Linku: https://www.umsh.edu.al/c/108/fakulteti-i-shkencave-psikologjike-sociale-dhe-politike 33 – RREGULLORE E ZKSK 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 8 - SYLLABUSE PROGRAMI I STUDIMIT 4 – RREGULLORE E UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ, nga takimi me studentët dhe stafin e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës konstaton se informojnë studentët mbi mundësitë e punësimit dhe organizojnë takime dhe trajnime për studentët që i ndihmojnë ata për aplikime të suksesshme për punë. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës është në dispozicion të studentëve për këshillimin e karrierës, iu jep studentëve informacion rreth mundësive të ndryshme që IAL UMSH në bashkëpunim me institucionet dhe kompanitë ofron për trajnime, internshipe, mundësi punësimi, etj. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit që vijnë në institucion prej kompanive apo sipërmarrjeve përmes ofertave që ato dërgojnë, duke i shpallur këto njoftime/thirrje në ambiente të dukshme të institucionit. Njoftimet/thirrjet e punësimit iu dërgohen dhe me email studentëve sipas grupeve dhe fushave përkatëse të studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> 33 – RREGULLORE E ZKSK Linku: https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres Linku: https://www.umsh.edu.al/c/108/fakulteti-i-shkencave-psikologjike-sociale-dhe-politike 21 – Screenshot për njoftim mundësi punësimi nga Zyra e Programeve Master 21 – Screenshot për njoftim mundësi punësimi nga Zyra e Programeve Master (2) 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 4 – RREGULLORE E UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të</p>	<p>Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë së bashku me dekanatin & koordinatorët e programeve organizojnë çdo vit takime informuese (si dhe përmes emailit) të përshtatjes së studentëve që regjistrohen në vitin e parë në programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh në IAL UMSH. Studentët pas</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

75




<p>tij.</p>	<p>regjistrimit në institucion, në mënyrë periodike informohen prej zyrave përkatëse lidhur me aksesin në Sistemin e Menaxhimit të Institucionit (SMS UMSH), adresën e tyre të emailit, etj. Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua se studentëve iu jepet një informacion i gjerë dhe i detajuar për aspektet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet, kohëzgjatjen e studimeve, planin mësimor, lëndët/modulet, mënyrat e vlerësimit, etj. Gjatë këtyre takimeve shpjegohen në detaje edhe struktura e IAL UMSH, struktura e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, prezantohen drejtuesit, stafi akademik, etj. Institucioni informon studentët në Javët e Hapura, si dhe informacion jepet në mënyrë të vazhdueshme dhe në faqen web të IAL UMSH, në standat e institucionit dhe rrjetet sociale. Studentët kanë akses në faqen zyrtare web të IAL UMSH (në kategorinë Studentët, ata gjejnë informacion për këshillat studentore, klubet studentore, këshillimin e karrierës, jetën studentore, alumni, orarin mësimor, kalendarin akademik, procesin e diplomimit, mundësitë e mobiliteteve, udhëzime të ndryshme, etj).</p> <p><i>Evidenca:</i> 33 – RREGULLORE E ZKSK Linku: https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres Linku: https://www.umsh.edu.al/c/108/fakulteti-i-shkencave-psikologjike-sociale-dhe-politike Linku: https://www.umsh.edu.al/c/174/njofitime Linku: https://www.umsh.edu.al/c/86/shkenca-psikologjike-sociale-dhe-politike (stafi akademik) 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 4 – RREGULLORE E UMSH 5 – RREGULLORE E FSHPSP 6 - RREGULLORE E DAPFB Takimi i GVJ me studentët</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Informacion të detajuar lidhur me programin e studimit studentët marrin nëpërmjet komunikimit në distancë që kanë me pedagogët dhe Sekretarinë Mësimore, nëpërmjet faqes zyrtare web të IAL UMSH, si dhe nëpërmjet emaileve zyrtarë që posedojnë. Informacione të tjera të vlefshme bëhen të mundura nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, ato nëpërmjet botimeve dhe fletëpalosjeve, si dhe informacioneve të tjera të cilët studentët i aksesojnë në faqen web të UMSH.</p> <p>Studentët e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh në IAL UMSH aksesojnë sistemin SMS UMSH përmes aksesit që ata kanë në emailin e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë (aksesimi është elektronik dhe studenti mund ta përdorë sistemin nga të gjitha formatet elektronike ... mjafton që studenti të ketë akses në adresën e tij elektronike të mundësuar prej IAL UMSH).</p>

	<i>Evidenca:</i> Linku: http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Takimi i GVJ me studentët		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se Zyra e sekretarisë mësimore të fakultetit është përgjegjëse për mbajtjen e statistikave vjetore për numrin e studentëve në secilin program studimi, dhe numrin e të diplomuarve përkatës në këto programe studimi. Sekretaria mësimore e fakultetit i disponon këto statistika (në formë hard copy dhe në mënyrë elektronike), të cilat mblidhen dhe përpunohen në bazë të ligjit të arsimit të lartë nr.80/2015, udhëzimit të MASH nr.9, datë 25.02.2010 ‘Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore’, dhe udhëzimit të MASR, nr.16, datë 08.07.2019 ‘Për pajisjen e IAL publike dhe private me regjistrat bazë të studentëve’. Statistikat mblidhen si prej Sekretarisë mësimore të fakultetit, ashtu dhe nga departamentet pas çdo sezoni diplomimi dhe u vihen në dispozicion strukturave drejtuese si dhe koordinatorit të programit të studimit. Në të njëjtën kohë këto statistika përfshihen edhe në raportet vjetore të fakultetit dhe institucionit. Konkretisht për këtë program studimi, janë 16 studentë në vitin e parë me notën mesatare në hyrje 7.7.]</p> <p><i>Evidenca:</i> 10 - PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore të fakultetit, GVJ u njoh me statistikën që mbante kjo zyrë për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektësh, që përmbanin të dhëna në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të dhëna për të larguarit, transferimet, përqindjen e kalueshmërisë, etj. Ato përfshihen në raporte të ndryshme, si dhe deklarohen në MAS apo ASCAL.</p> <p>Konkretisht në programin MP në Hartim, Menaxhim Projektësh për vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar 16 studentë për herë të parë me notën mesatare në hyrje 7.7. Ky është viti ku pritet të diplomohen studentët e parë që ndjekin këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>10 - PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p> <p>Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike në IAL UMSH disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, duke ndjekur ecurinë e studentëve të programit të studimit përmes regjistrave të lëndëve dhe të dhënave të mbledhura prej stafit akademik për prezencën, mungesat, pjesëmarrjen aktive në orën mësimore, angazhimin në projekte, detyra kursi, vlerësime etj.</p> <p>Për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, në vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar dhe frekuentojnë 16 studentë në vitin e parë me notën mesatare në hyrje 7.7. Ky është viti ku pritet të diplomohen studentët e parë që ndjekin këtë program studimi. Nga drejtues të IAL specifikohet që të gjithë këta studentë janë me eksperiencë pune dhe janë të punësuar.</p> <p><i>Nga GVJ sugjerohet që të bëhet më shumë punë për të rritur numrin e regjistrimeve të studentëve që ndjekin studimet MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, kjo për të ndikuar në të ardhurat e IAL UMSH, por dhe për të fuqizuar këtë program studimi dhe për ta përmirësuar më tej.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>10 - PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga sekretaria mësimore e fakultetit, e cila synon të ruajë privatësinë dhe këto të dhëna iu vendosen në dispozicion vetëm personave të autorizuar (studentët, pedagogët, drejtuesit e institucionit, etj). Tek sekretaria mësimore e fakultetit gjendet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i notave, regjistri i lëshimit të diplomave, procesverbalet e notave, etj. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat ruhen në dokumenta fizikë dhe në mënyrë elektronike. Gjatë vizitës në IAL UMSH, përfaqësues të sekretarisë mësimore të fakultetit na vunë në dispozicion regjistrin themeltar të studentëve për këtë program studimi i plotësuar sipas standardeve që kërkon ligji, si dhe procesverbale notash të lëndëve që përmban programi i studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. Të dhënat plotësohen edhe në Sistemin e Menaxhimit të Institucionit (SMS UMSH), ku stafi akademik i hedh ato dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vet studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre, si dhe të informohen për mungesat, vlerësimet, etj. nëpërmjet sistemit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>10 - PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP</p> <p>Linku: http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar 26 - UDHEZUES I PERDORIMIT TE SISTEMIT SMS</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL UMSH, GVJ u informua se departamentet dhe sekretaria mësimore e fakultetit hartojnë raporte mbi cilësinë në hyrje</p>

<p>dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>dhe në dalje të studentëve (për cilësinë në dalje, për këtë vit akademik, të dhënat do merren pas përfundimit të këtij viti akademik). Këto analiza dhe raporte që hartohen kryesisht nga Departamentet në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore të fakultetit (e cila kryesisht ndihmon me statistikat) vihen në shërbim të njësive dhe drejtuesve të IAL UMSH për të bërë analiza e studime të mëtejshme dhe për të marrë masa përmirësimi në të ardhmen. Të dhënat mblidhen & përfshihen në raportet që përgatit departamenti, sekretaria, dhe fakulteti për strukturat drejtuese, dhe ku më pas i vihen në dispozicion edhe njësive të tjera (si NJSBC, etj) të cilat më pas i analizojnë dhe konkludojnë duke dhënë sugjerimet përkatëse. Gjithashtu, IAL UMSH ka realizuar studimin e tregut për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh, ndër të tjera për të analizuar mundësitë e punësimit të studentëve të këtij programi duke dhënë konkluzione dhe rekomandime për zhvillimin e programit në të ardhmen.</p> <p>Për këtë program studimi, në vitin akademik 2021-2022 po ndjekin studimet studentët e parë, por IAL UMSH mban kontakte të vazhdueshme me këta studentë, si dhe do i mbajë dhe në të ardhmen me konsolidimin e këtij programi studimi, duke ndjekur ecurinë, punësimin dhe arritjet e tyre, si dhe njësia kryesore mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre dhe organizon aktivitete të dedikuara për alumni (edhe të programeve të tjera të studimit) duke vlerësuar eksperiencën e tyre si një vlerë të çmuar për të vlerësuar dijet dhe aftësitë që ata kanë marrë dhe do marrin gjatë periudhës së studimeve në IAL UMSH. Propozimet e studentëve aktuale dhe atyre alumni për përmirësime në programin e studimit janë gjithnjë të mirëpritura për IAL UMSH, aty ku është e mundur dhe reale, apo me vlerë për programin dhe studentët pasardhës.</p> <p><i>GVJ mendon që analiza e tregut të punës duhej më e zgjeruar.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> 10 - PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP 9 - ANALIZE E TREGUT TE PUNES</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të</p>	<p>IAL UMSH parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

79

<p>tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>ligjit të arsimit të lartë nr. 80/2015 dhe akteve rregullatore të IAL UMSH.</p> <p>Në bazë të Statutit të UMSH, studentët kanë të drejtë të zgjidhen në: Senatit Akademik, ku studentët përfaqësohen në masën 10% sipas Statutit; dhe në Këshillat e studentëve (zgjidhen çdo 2 vite nga votat e studentëve), që janë organizime të pavarura të studentëve të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike, dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi;</p> <p><i>GVJ mendon që duheshin dhe vendimet e emërimit të përfaqësuesve të studentëve në Senat dhe Këshillat Studentore!</i></p> <p><i>Evidenca:</i> 1 – STATUTI I UMSH 4 – RREGULLORE E UMSH 33 – RREGULLORE E ZKSK RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL UMSH, në takimin me studentët GVJ u informua se nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar vazhdimisht në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të IAL UMSH. Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, dhe Dekanati i mirëpresin sugjerimet dhe vërejtjet e studentëve për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe marrëdhënien me IAL UMSH. IAL UMSH garanton se përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillimin apo vlerësimin e procesit mësimor është reale dhe studentët konkretisht përfaqësohen në masën 10% në Senatit Akademik, si dhe janë përfshirë në procese vlerësimesh të brendshme dhe të jashtshme, në projekte institucionale, mobilitete, vlerësimin e stafit akademik, etj. Studentët përfaqësohen edhe në Këshillat Studentore (zgjidhen çdo 2 vite nga votat e studentëve). Studentët kanë hapësirën e tyre në faqen web të IAL UMSH tek kategoria Studentët, seksion që i dedikohet atyre me njoftime të ndryshme, udhëzime, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> 1 – STATUTI I UMSH 4 – RREGULLORE E UMSH 33 – RREGULLORE E ZKSK Linku: https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota</p>	<p>IAL UMSH ofron programin e studimit të ciklit të dytë MP në Hartim, Menaxhim Projektesh me një kohëzgjatje 1 vit dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 60 kredite evropiane (ECTS). Viti akademik zgjat 30 javë mësimore, i ndarë në dy semestra me nga 15 javë. Kreditet e aplikuar për lëndët/modulet (7) janë nga 6 ECTS; praktika 6 ECTS dhe diploma 12 ECTS. Ka një shpërndarje të ekuilibruar midis numrit të orëve në auditor plus studimit individual,</p>

<p>apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>shpërndarje e cila lehtëson edhe procedurat për transferimin e studentëve nga IAL të tjera ose drejt UMSH. Ngarkesa akademike e studentëve në programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe VKM nr.41. datë 24.01.2018, të ndryshuar. Ngarkesa totale e orëve në auditor për vitin akademik është 600 orë, kurse jashtë auditorit 900 orë. Gjatë hartimit dhe përmirësimit të këtij programi studimi, ngarkesa e akademike është marrë në konsideratë, si dhe është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve apo dhe njohjet e studimeve të mëparshme bëhen në përputhje me rregulloren e IAL UMSH, të departamentit dhe të programit të studimit, procedura të cilat janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i> 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 10 - PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP 8 - SYLLABUSE PROGRAMI I STUDIMIT 4 - RREGULLORE E UMSH</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga takimi me drejtues dhe studentë të IAL UMSH, GVJ konstaton se IAL garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Nëpërmjet anëtarëve të këshillave të studentëve apo studentëve anëtarë të senatit, përcillen kërkesat apo sugjerimet e studentëve në nivelet drejtuese të të gjitha niveleve. Studentët janë të përfshirë gjithashtu në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e programeve të ndryshme të studimit. Duke pasur përfaqësues në Senatin Akademik, studentët janë pjesë e organeve kolegjiale vendimmarrëse.</p> <p>IAL UMSH organizon takime periodike me Këshillin e Studentëve, Fokus Grupe me studentët, si dhe organizon pyetësorë nëpërmjet NjsbcZHK (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës) për vlerësimin e programeve të studimit dhe stafit akademik, (si dhe nëpërmjet bërjes së takimeve dhe anketimeve të rregullta), dhe më pas përpunimin e pyetësorëve të studentëve ku studentët mund të lënë komente sipas këndvështrimit të tyre në ato fusha ku ka nevojë për përmirësime të procesit. Në këtë mënyrë studentëve u jepet mundësia të komentojnë lidhur me pedagogët dhe problematikat e hasura gjatë zhvillimit të programit të studimit. Feedback-u i marrë prej takimeve periodike si dhe prej vlerësimeve të studentëve përbën thelbin e përfshirjes së tyre në proceset akademike institucionale. Në fund, krijohen raporte, të cilat diskutohen konkretisht në mbledhjet e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë për të marrë masa në lidhje me shqetësimet apo sugjerimet e ngritura nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i> 16' - Vendim i krijimit të NJSBC-se dhe GVB-se</p>

	<p>17' - Procedure pune e NJSBC 18' - Raport monitorimi dhe e vlerësimit të pedagogut (2) 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 12 - MANUAL I NJSBCZHK 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 4 - RREGULLORE E UMSH</p>						
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët (16 studentë që frekuentojnë aktualisht për herë të parë këtë program studimi), GVJ u informua se atyre iu mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, iu jepet mundësia të vlerësojnë performancën e stafit akademik në të gjitha aspektet e procesit mësimor (që nga procesi i mësimdhënies deri tek mënyrat e vlerësimit të lëndës/modulit). Studentët e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh njihen me rezultatet/pikët e marra gjatë semestrit përpara provimit, dhe me rezultatin e provimit pas zhvillimit të provimit në një afat sa më të shpejtë të mundur. Elementët kryesorë të vlerësimit përmbushin parimin e kontrollit të vazhdueshëm duke përfshirë: provimet, detyrat në grup, aktivizimin në seminare, provimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, provimin përfundimtar, etj.</p> <p>Studentët pohuan se iu jepet e drejta të ankohen për shkelje të rregullave të provimit, gabime ose pasaktësi në provim, ku ankesa (pasi konsumohet procedura e sqarimit me pedagogun e lëndës) me shkrim dorëzohet tek sekretaria mësimore dhe i drejtohet Dekanit brenda 2 ditëve nga data e dhënies së provimit, i cili nga ana e tij ngre një komision. Dekani me miratimin e Rektorit dhe sëbashku me Koordinatorin e Programeve Master, Përgjegjës të Departamentit dhe komisionin e provimit verifikojnë shkeljen dhe në rast se ankesa është e drejtë, vendosin për anulimin e provimit. Përsëritja e provimit bëhet pas sezonit të rregullt të provimeve (sipas rregullores së departamentit dhe atë të këtij programi studimi). GVJ i pyeti drejtuesit dhe studentët që a ka patur procedura ankimimi nga studentët që kanë kaluar nëpër hallkat drejtuese, por ata thanë që nuk ka patur të tilla; edhe nëse ka patur është zgjidhur që në hallkën e parë nga ballafaqimi me pedagogun përkatës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 7 - RREGULLORE E PROGRAMIT MPHMP 6 - RREGULLORE E DAPFB 4 - RREGULLORE E UMSH 5 - RREGULLORE FSHPS 1 - STATUTI UMSH</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>IAL UMSH ka njësi e procedura të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL UMSH. Këto njësi janë zyrat administrative të detyrueshme me ligj, siç janë sekretaritë mësimore të fakulteteve, ajo e rektoratit, e administratorit, ku detyra e tyre është që të mbështesin studentin dhe të informojnë sipas përcaktimeve ligjore që lidhen ngushtësisht me statusin e studentit. Lidhur me informimin e studentëve janë të përfshirë edhe koordinatorët e programeve të studimit të cilët përmes eksperiencës që kanë si dhe njohjes së mirë të programeve mësimore këshillojnë studentët mbi informacionet që ata kërkojnë për kreditet, vlerësimin, mobilitetet, transferimet, praktikat mësimore etj. IAL UMSH ka ngritur dhe struktura mbështetëse në shërbim të studentëve dhe informimit të tyre të tilla si: Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e shërbimit të studentëve, këshillon dhe orienton studentët lidhur me përzgjedhjen e kompanive për zhvillimin e praktikës profesionale si dhe përzgjedhjen e temave të diplomave. Studentët informohen dhe nga webi zyrtar i IAL UMSH, apo nëpërmjet emaileve zyrtare apo dhe në rrjetet sociale si formë alternative.</p> <p><i>Evidenca:</i> 4 – RREGULLORE E UMSH 1 - STATUTI UMSH Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, ajo e burimeve njerëzore, sekretaritë e fakulteteve, ajo e rektoratit, e administratorit, asistojnë studentin që nga regjistrimi deri në diplomim, ofrojnë informacion e këshillim për çështje të lidhura me procesin mësimor dhe përfshirjen e studentëve në tregun e punës, vendin ku do të kryejnë praktikën, përzgjedhjen e karrierës, etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe informimin e studentëve ka Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, përgjegjës për këtë program studimi, ku stafi akademik përkatës i ndihmon studentët për çdo nevojë apo problematikë që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Tutoriati dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik në të njëjtin orar të shpallur që në fillim të vitit, ku brenda këtij orari zhvillohen dhe seancat këshillimore. Pedagogu këshillues duhet të ketë informacione në lidhje me studentët e konsultuar dhe për çështjet e diskutuara. Gjithashtu informimi i studentëve bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të web-it të IAL UMSH.</p>

	<p><i>Evidenca:</i> 33 – RREGULLORE E ZKSK Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>IAL UMSH ka ngritur struktura mbështetëse në shërbim të studentëve dhe informimit të tyre të tilla si Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, e cila mirëpret studentët duke iu ofruar informacione dhe orientim të posaçëm në lidhje me programet mësimore, ciklet e studimit, karrierën, praktikat profesionale, kërkesat e tregut të punës, etj. Ajo informon kandidatët dhe studentët brenda e jashtë institucionit lidhur me programet mësimore, ciklet, procedurat dhe afatet e regjistrimit të tyre. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës bashkëpunon në rastin konkret me Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë për organizimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi, organizon panairt e punës, mban marrëdhënie me studentët e diplomuar/alumni, i ofron studentëve mundësi për ndjekjen e shkollave verore, organizon seminare, etj. Kjo zyrë iu jep studentëve informacion të plotë mbi çdo gjë që ka të bëjë me liçensimin e programeve, mundësitë e karrierës dhe punësimit, akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, marrëveshjet e bashkëpunimit, njohjen e krediteve etj, si dhe ruan lidhje të ngushta me Këshillin Studentor për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të studentëve. Të dyja këto njësi bashkëpunojnë dhe me sekretaritet mësimore, NjSBCZhK, etj, dhe përgatisin të dhëna statistikore dhe i prezantojnë ato për analiza të mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca:</i> 33 – RREGULLORE E ZKSK Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në IAL UMSH ka si detyrë të grumbullojë informacione mbi të diplomuarit dhe të përgatisë raporte për shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Kjo zyrë në bashkëpunim me struktura të tjera institucionale si sekretaritet mësimore, NjSBCZhK, etj, ndjek aktivitetet e zhvilluara prej studentëve dhe njëkohësisht pas përfundimit të studimeve prej tyre, ndjek dhe ecurinë e punësimit dhe zhvillimit të tyre të karrierës, si dhe përgatit të dhëna statistikore dhe i prezanton ato për analiza të mëtejshme. Bazuar në këto të dhëna, si dhe në bashkëpunim me koordinatorët institucionalë për Alumni, janë organizuar takime dhe aktivitete me studentët e diplomuar ndër vite. Edhe për studentët e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh të cilët ndjekin për herë të parë këtë program studimi, mbahen të dhënat e kontakteve të tyre (emaile, shkollime të mëparshme, punësimin, etj), dhe sipas drejtuesve të IAL UMSH, edhe në përfundim të studimeve të tyre do të mbeten në kontakt të përhershëm me ata, pasi studentët janë ura lidhëse midis programit dhe tregut të punës.</p>

	<i>Evidenca:</i> 33 – RREGULLORE E ZKSK 22 - Model Tabele excel për ruajtjen e të dhenat Alumni RVB e IAL UMSH		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	IAL UMSH ka politika dhe struktura për sigurimin e cilësisë, të tilla si Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NjSBCZhK), si strukturë kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë të arsimit të lartë, udhëzimet e ASCAL, Statutin dhe aktet e tjera rregullatore institucionale. NjSBCZhK është njësi përgjegjëse për zbatimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, dhe synon garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të UMSH, & për zhvillimin e kurrikulave. Statuti i IAL UMSH përcakton qartësisht parimet e funksionimit dhe ato mbi të cilat ngrihet dhe mbështetet puna e NjSBCZhK për sigurimin e cilësisë, strukturë e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe zhvillimin e kurrikulave. NjSBCZhK është organ kolegjal dhe përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët janë përfaqësues nga secila prej njësive kryesore të universitetit. Rektori i UMSH emëron dhe shkarkon drejtuesin e NjSBCZhK. NjSBCZhK vlerëson dhe raporton periodikisht pranë Rektorit dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të IAL në aspektin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

85

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>1 – STATUTI I UMSH 4 – RREGULLORE E UMSH 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC Takimi në IAL UMSH me stafin e NjsBCZhK RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>IAL UMSH gjatë këtyre viteve ka ndjekur një strategji institucionale lidhur me sigurimin e cilësisë në IAL. Sigurimi i cilësisë ka pasur karakter gjithëpërfshirës si nga stafi akademik ashtu dhe nga studentët dhe është shoqëruar me kërkesa gjithnjë në rritje për realizimin e të cilave nga secili punonjës kërkohet maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm. GVJ konstaton që IAL UMSH ka ngritur strukturën për sigurimin e cilësisë, konkretisht Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NjsBCZhK) nëpërmjet të të cilës zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë & zhvillimin e kurrikulave, dhe ka një sistem funksional. NjsBCZhK monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetësorit të stafit akademik (si dhe Fokus Grupet me studentët) dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, dhe ndërmerr hapa për rishikimin e vazhdueshëm të kurrikulave, etj.</p> <p>Qëllimet e NJSBC-së janë rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të IAL UMSH, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative; aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së UMSH, duke zbatuar një program akademik që përkon me synimet që ka UMSH; rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies; dhe rishikimi i vazhdueshëm i kurrikulave. IAL UMSH ka angazhuar dhe ekspertë të jashtëm të cilët kanë sjellë këndvështrimet e reja për probleme të ndryshme, eksperiencia pozitive dhe praktika të përparuara.</p> <p><i>Ka një mospërputhje për numrin e anëtarëve të NjsBCZhK ... në rregulloren e UMSH thuhet 7 anëtarë, përfaqësues të njëjësive kryesore të IAL, tek Evidenca 10 & nga takimi me përfaqësues të NjsBCZhK thuhet 10 anëtarë, kurse te RVB thuhet 9 anëtarë, ku përfshihet dhe 1 student?! Si dhe duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>1 – STATUTI I UMSH 4 – RREGULLORE E UMSH</p>





	<p>12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise 10 - PERMBLEDHJE E TABELAVE PER PROGRAMIN MPHMP Takimi në IAL UMSH me stafin e NjsBCZhK RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL UMSH përdor instrumentat e duhura të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Gjithshtu vlen të theksohet që programi i studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektësh i ofruar nga IAL UMSH po i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm (akreditimit) për herë të parë. UMSH përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse (përdor pyetësorë fizikë si dhe Fokus Grupet me studentët) për sigurimin e cilësisë në institucion si dhe për të ndjekur ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, kurrikulave, etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit, proces i cili organizohet nga NjsBCZhK për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe ku rezultatet e tyre i raportohen rektoratit, dekanateve të fakulteteve dhe zyrës së burimeve njerëzore. NjsBCZhK jep rekomandime mbi përmirësimin e hapave që duhen ndjekur për të qenë në koherencë të plotë me zbatimin e kërkesave të MAS si dhe atyre në lidhje me përmbushjen e procedurave që duhet të ndiqen për akreditimin e programeve të studimit. NjsBCZhK bashkëpunon ngushtësisht me ASCAL duke marrë pjesë jo vetëm në trajnimet dhe takimet e organizuara prej tyre rreth cilësisë, standardeve dhe proceseve të vlerësimit, por edhe duke organizuar takime me natyrë informuese dhe sqaruese për proceset e vetëvlerësimit, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 1 – STATUTI I UMSH 4 – RREGULLORE E UMSH Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise Takimi në IAL UMSH me stafin e NjsBCZhK RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë</p>	<p>GVJ konstaton se IAL UMSH për sigurimin, monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit ka hartuar procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, si dhe ka hartuar politika periodike në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, që synojnë përmirësimin e programeve të</p>


<p>krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>studimit që ofron. Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit janë thelbësore për misionin e IAL UMSH. Statuti dhe rregulloret përcaktojnë kornizën bazë për vlerësimin e cilësisë dhe realizueshmërisë së të gjitha programeve, si dhe për monitorimin dhe rishikimin sistematik të tyre.</p> <p>NjsBCZhK e IAL UMSH e ka përqëndruar punën për sigurimin e cilësisë në monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e programeve të studimit si dhe vlerësimin e syllabuseve të lëndëve. Vlerësimet e kryera sipas kësaj politike dhe rezultatet e tyre janë pjesë e kuadrit procedural të miratimit dhe rishikimit të programit të UMSH. Procesi i vlerësimit të programit përfshin: monitorimin dhe rishikimin e programit; vlerësimin e programit të lëndës; vlerësimin e mësimdhënies, stafit akademik. Ajo është e angazhuar në anketimin e studentëve dhe stafit akademik, përdorimin e Fokus Grupeve me studentëve, hartimin e raporteve të të dhënave të marra nga pyetësorët (në fund të çdo semestri zhvillohen pyetësorët për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut të lëndës), përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, etj. NjsBCZhK përgatit një raport vjetor në fund vitit akademik në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë, raport i cili analizohet në mbledhjet e departamenteve ku merren vendime për ndryshime apo përmirësime të mundshme (të dhënat e përpunuara raportohen pranë Rektorit, Senatit Akademik, Dekanateve dhe Departamenteve). Drejtuesit e IAL UMSH me strukturat e tyre synojnë krijimin e kulturës së cilësisë të të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i> 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit të NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 1 - STATUTI I UMSH 4 - RREGULLORE E UMSH Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise Takimi në IAL UMSH me stafin e NjsBCZhK RVB e IAL UMSH RVB e IAL UMSH</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi VI.2
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe





rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se IAL UMSH në funksion të monitorimit, shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së programeve të studimit ka ngritur Komisionin e Përherëshëm pranë njësisë kryesore (organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë, ku 4 anëtarë emërohen nga radhët e Asamblesë së Personelit Akademik & 1 anëtar është student ... anëtarët janë me mandat 2 vjeçar). Funkcioni i këtij komisioni është për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë kryesore, programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët. Procedura për rishikimin dhe modifikimin e elementëve të programit të studimit, zakonisht mund të fillojë në rastin konkret nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, ku mund të bëhen ndryshime deri në masën 20% sipas ligjit. Nëse kërkohet të bëhen ndryshime më të mëdha, atëherë ndiqen hapat e përcaktuara në ligjet, vendimet dhe udhëzimet përkatëse të MAS.</p> <p><i>GVJ konstaton që mungon vendimi i emërimit të anëtarëve të Komisionit të Përherëshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë kryesore, programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët, si dhe duhej më shumë informacion për punën dhe arritjet e këtij komisioni.</i></p> <p><i>Gjithashtu, GVJ sugjeron që NjsBC të ishte e 'pastër' dhe më e fokusuar, kurse për pjesën e kurrikulave të krijohej Komisioni Përherëshëm për Zhvillimin e Kurrikulave, dhe puna e tij të ishte më e specializuar dhe fokusuar, gjë e cila do të sillte më shumë efikasitet dhe efektivitet.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>1 – STATUTI I UMSH 4 – RREGULLORE E UMSH RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ, në takimin me Përgjegjësen e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, përgjegjëse për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, u informua se në fillim të çdo viti akademik kërkohen nga stafi akademik mendime apo sugjerime në lidhje me përditësimin e syllabuseve dhe miratohen ndryshimet e mundshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, në përfundim të çdo semestri, Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë diskuton dhe analizon raportet e krijuara nga rezultatet e pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve që realizohen nga NjsBCZhK e IAL UMSH.</p> <p>Kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik është në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe synon arritjen e objektivave</p>



	<p>dhe standardeve bashkëkohore, që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve. Kontrolli realizohet nëpërmjet vlerësimit të çdo pedagogu dhe lënde nga vetë studentët, vetëvlerësimit të performancës nga çdo pedagog, vlerësimit prej eprorëve respektivë të punës së realizuar nga pedagogët, dhe vlerësimit administrativ për aspekte të tilla si respektimi i orarit, niveli i shfrytëzimit të orës së mësimi, korrektesa e çdo pedagogu, etj. Ka një bashkëpunim të vazhdueshëm të NJSBCZhK, ZKSK dhe Departamenteve në formën e grupeve ad-hoc për shqyrtimin e çështjeve të cilësisë dhe vlerësimin e personelit. Shumë aktivitete dhe procedura realizohen bashkërisht nga personeli akademik dhe ai ndihmës, me koordinimin e strukturës administrative të institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i> 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit të NJSBC-se dhe GVB-se 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 17 - Procedure pune e NJSBC 1 - STATUTI I UMSH 4 - RREGULLORE E UMSH RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>IAL UMSH përdor një metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për të parë ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Konkretisht, mekanizmat kryesorë që përdor NjsBCZhK për mbikqyrjen e programeve të studimit dhe të procesit mësimor janë: pyetësi i studentëve për zhvillimin e mësimi dhe për vlerësimin e kursit, formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik, si dhe Fokus Grupet me studentët.</p> <p>Këto vlerësime zhvillohen në mënyrë fizike dhe përpunohen prej NjsBCZhK. Të dhënat e përpunuara në formë raporti iu dërgohen Rektorit, Senatit Akademik, Dekanëve dhe në mënyrë konfidenciale të gjithë stafit të UMSH. Vlerësimi i studentëve për pedagogun e lëndës, në formë të përmbledhur, sipas pikëve të grumbulluara u dërgohet secilit pedagog përmes adresës së emailit në mënyrë private. Gjithashtu, organizohen takime të përbashkëta të NjsBCZhK me pedagogët, studentët, stafin administrativ, etj ku shkëmbehen mendime dhe ide se ku ka nevojë për të bërë përmirësime. Gjatë vlerësimit përdoret Manuali i Sigurimit të Brendshëm Cilësisë, i cili ka në fokus programet e studimit, stafin akademik përgjegjës për programin e studimit dhe studentët.</p>




	<p>IAL UMSH kryen vlerësime në mënyrë të vazhdueshme me theks në sistemin në tërësi (institucionin) dhe vlerësime për programet e studimit, me fokus në cilësinë e mësimdhënies dhe programet e lëndëve. Sa i përket vlerësimit të programit të studimit ai kryhet përmes instrumenteve matës: Vlerësimi prej studentëve në fund të çdo semestri i programit të lëndës dhe pedagogut të lëndës përmes pyetësorit të hartuar prej NJSBCZhK; Vlerësimi periodik i programeve mësimore prej NJSBCZhK; Vetëvlerësimi i stafit akademik sipas modelit të hartuar dhe miratuar prej Senatit Akademik të IAL UMSH.</p> <p><i>Evidenca:</i> 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit të NJSBC-se dhe GVB-se 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 17 - Procedure pune e NJSBC 1 - STATUTI I UMSH 4 - RREGULLORE E UMSH RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të përfësorëve përpunohen prej njësave përkatëse dhe në fund përpilohen raporte (me tabela, shifra e të dhëna) nga NJSBCZhK, dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, konkretisht Rektorit, Senatit Akademik, Dekanëve të fakulteteve respektive dhe në mënyrë konfidenciale të gjithë stafit të UMSH.</p> <p>Në raportet që hartohen jepet informacion mbi problematika të ndryshme të hasura që kanë lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe rekomandimet përkatëse për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.</p> <p>Në raport përfshihet edhe baza ligjore mbi të cilën mbështetet anketimi i studentëve si dhe metodologjia e hartimit të raportit. Të dhënat (raportet nga pyetësorët) publikohen dhe në faqen zyrtare të internetit të IAL UMSH: www.umsh.edu.al. Institucioni synon që të jetë transparent dhe të informojë studentët, stafin si dhe të gjitha palët e interesuara mbi ecurinë e procesit mësimor në institucion, ashtu si dhe të publikojë vlerësimin e studentëve për këtë proces.</p> <p><i>Evidenca:</i> 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit të NJSBC-se dhe GVB-se</p>




	<p>20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR</p> <p>21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI</p> <p>23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE</p> <p>17 - Procedure pune e NJSBC</p> <p>1 - STATUTI I UMSH</p> <p>4 - RREGULLORE E UMSH</p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</p> <p>RVB e IAL UMSH</p>						
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet e vlerësimit që hartohen nga NjsBCZHK përfshijnë vlerësimin e situatës, kryesisht të gjërave që kanë lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe jepen rekomandimet/masat që duhen marrë nga departamentet apo njësitë përkatëse të tjera për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e elementëve të duhura që nuk janë siç duhet. Nga ana tjetër, edhe Departamentet bëjnë analizën e tyre vjetore dhe hartojnë një raport me të gjithë elementët përkatës, duke përfshirë stafin akademik, strukturën mësimore, studentët, bashkëpunimin me IAL të tjera dhe më njësi të tjera në IAL UMSH, etj, si dhe vendosen objektivat për të ardhmen.</p> <p>Njëkohësisht një formë e vlerësimit sidomos për stafin akademik është edhe vlerësimi i tij prej strukturave përgjegjëse e drejtuese në fund të çdo vitit akademik.</p> <p>Njësitë kryesore dhe ato bazë i analizojnë konkluzionet me stafet e tyre akademike dhe ndërmarrin veprime me hapa konkretë për ndryshimin e situatës apo përmirësimin e saj. Vlen të theksohet që në fund të këtij viti do të përfshihen për herë të parë dhe rezultatet e vlerësimit për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>12 - MANUAL I NJSBCZHK</p> <p>34 - RREGULLORE NJSBCZHK</p> <p>16' - Vendim i krijimit të NJSBC-se dhe GVB-se</p> <p>20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR</p> <p>21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI</p> <p>23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE</p> <p>17 - Procedure pune e NJSBC</p> <p>1 - STATUTI I UMSH</p> <p>4 - RREGULLORE E UMSH</p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1787 751 1854">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="751 1787 962 1854">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="962 1787 1361 1854">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1854 751 1899"></td> <td data-bbox="751 1854 962 1899" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="962 1854 1361 1899"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						






Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisë e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL UMSH kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programit të studimit nëpërmjet NjsBCZhK. Gjatë vitit akademik NjsBCZhK realizon vlerësime duke e bazuar kryesisht raportimin në analizën e pyetësorëve të studentëve (në fund të çdo semestri përpara provimeve përfundimtare, vlerësimi i kryer në mënyrë fizike), Fokus Grupeve me studentët, ku vlerësohet programi i lëndës dhe pedagogu i lëndës) për procesin mësimor për çdo semestër mësimi. Për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektësh është ngritur GVB i cili ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si pjesë përbërëse e dokumentave për akreditimin e këtij programi studimi. Departamentet i përdorin raportet e NjsBCZhK në kuadër të akreditimeve apo dhe të vlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p><i>Evidenca:</i> 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 1 - STATUTI I UMSH 4 - RREGULLORE E UMSH Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit, NjsBCZhK përdor metoda dhe instrumenta të ndryshme të cilat ndahen në metoda të drejtpërdrejta dhe ato tërthore të përcaktuara edhe në rregulloret përkatëse si dhe në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Instrumentet e përdorura përfshijnë pyetësorët për studentët; Fokus Grupet me studentët; pyetësorë për pedagogët; takimet e përbashkëta me pedagogët dhe departamentet; intervista me studentët; takime me stafin administrativ, etj) për vlerësimin e cilësisë së programit dhe mbarëvajtjes së tij, instrumenta të drejtpërdrejta ose të tërthorta në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Gjithashtu, edhe Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë bën analizën vjetore të tij për çdo vit akademik ku trajton me detaje ecurinë e programeve të tij të studimit dhe përmirësimet potenciale në të ardhmen.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 – RREGULLORE E UMSH Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimet paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>NjsbcZHK realizon vlerësimin e programit të studimit, të planeve mësimore, të syllabuseve në lidhje me objektivat, përputhshmërinë e tyre me përmbajtjen e lëndëve/moduleve, shpërndarjen e ngarkesës së orëve gjatë vitit akademik për stafin akademik, ngarkesën e orëve për studentët, vlerësimin e materialeve didaktive, etj. Bëhet vlerësimi i performancës së stafit akademik nëpërmjet të cilit vlerësohen hartimi i leksioneve të reja, përditësimi i syllabusit dhe literaturës, niveli i kërkimit shkencor, etj. Instrumenta të tjera janë edhe metodat & monitorimet e drejtpërdrejta gjatë procesit të mësimin, vlerësimi i kontrollit të provimeve, kontrolli i procesverbaleve, etj. Metodatat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit përfshijnë: takimet e autoriteteve drejtuese me studentët dhe me Këshillin Studentor, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit dhe me studentët Alumni, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testimeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve të një programi, etj. Përdoren dhe sondazhet e studentëve që ndjekin programin e studimit, sondazhet e vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, dhe fokus grupet me studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 – RREGULLORE E UMSH</p>

	Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>NJSBCZHK kryen gjithashtu sondazhe dhe intervista me studentët dhe takime me stafin akademik të programit të studimit në lidhje me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe mundësitë potenciale për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh. Bëhen takime dhe me stafin ndihmës akademik dhe administrativ (si punonjës të vijës së parë që janë më në kontakt me studentët) të IAL UMSH në mënyrë që mendimet e tyre të reflektohen në vendimmarrjet e ardhshme nga ana e drejtuesve të institucionit. Metodatat e tërthorta të përdorura në procesin e vlerësimit përfshijnë raportet vjetore & raportet e vlerësimit të programit & raportet e vlerësimit prej strukturave drejtuese; vetëvlerësimi i stafit akademik; Raportet e Vlerësimit të Brendshëm & Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për proceset e akreditimit të programeve; vlerësimet nga studentët Alumni & gjurmimin e tyre lidhur me punësimin, për punësimin në profil ose jashtë tij; etj. Duhet thënë që këtë vit akademik diplomohen studentët e parë që ndjekin këtë program studimi, por institucioni ka krijuar një databazë me të dhënat dhe kontaktet e tyre për të ruajtur komunikimin në të ardhmen në interes të ndërsjelltë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>16 - FORMULAR I STUDENTIT ALUMNI 3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16* - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 - RREGULLORE E UMSH</p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë	Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar si dhe nga informacionet e marra gjatë vizitës në IAL UMSH, GVJ konstaton përfshirjen e


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

95

<p>përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>aktorëve të brendshëm në strukturat e ngritura për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të veta të studimit. Në strukturën e NJSBCZHK janë përfshirë anëtarë përfaqësues të njëjësive kryesore, kurse te GVB janë përfshirë dhe përfaqësues të studentëve (për vlerësimin e brendshëm ngrihen grupe pune me staf akademik, por duke përfshirë dhe përfaqësues të studentëve). Në funksion të sigurimit të cilësisë institucioni e sheh përfshirjen e palëve të treta, të tillë si ekspertë të bizneseve, sipërmarrjeve, etj. si një element shumë të rëndësishëm. Konkretisht, sipas drejtuesve të IAL, institucioni dhe njësitë kryesore kanë angazhuar ekspertë të jashtëm në vlerësimin e programeve të studimit, ashtu siç dhe kanë marrë mendimin dhe opinionin e ekspertëve nga industria, biznesi dhe sipërmarrja në takimet e organizuara me qëllim përmirësimin e programit të studimit ose të programeve të lëndës. Në lidhje me studentët, IAL UMSH i ka përfshirë edhe në Senatin Akademik dhe Komisionin e Përhershëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë kryesore, programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët, me synim që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh nga institucioni.</p> <p><i>GVJ konstaton që mungon vendimi i emërimit të anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë kryesore (ku bën pjesë dhe 1 student), programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët. Si dhe duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> 12 - MANUAL I NJSBCZHK Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore 1 – STATUTI I UMSH 16 - FORMULAR I STUDENTIT ALUMNI 22 - PROGRAM I TRAJNIMEVE 2020-2021 3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 – RREGULLORE E UMSH</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të</p>	<p>Në IAL UMSH, për sigurimin e brendshëm të cilësisë është ngritur NjsbcZHK, ku krijimi, organizimi dhe funksionimi janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UMSH. NjsbcZHK bashkëpunon me departamentet dhe me njësitë e tjera në mënyrë të</p>






<p>studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>vazhdueshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe përmirësimin e programeve të studimit. Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Rregullorja e NjsBCZhK dhe Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Nga ana tjetër, procedura për përmirësimin e cilësisë (ashtu si dhe manuali dhe rregullorja e cilësisë) përcaktojnë dhe njësitë bazë/departamentet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>34 - RREGULLORE NJSBCZHK 12 - MANUAL I NJSBCZHK Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore 1 - STATUTI I UMSH 16 - FORMULAR I STUDENTIT ALUMNI 22 - PROGRAMI TRAJNIMEVE 2020-2021 3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 - RREGULLORE E UMSH</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>NjsBCZhK ka përbërje institucionale duke përfshirë përfaqësues prej njësite kresore të IAL. Nga hulumtimi i dokumentave dhe takimi me drejtues të IAL UMSH, shihet se ai garanton përfshirjen e drejtpërdrejtë të njësisë bazë (Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë) dhe asaj kryesore (dekanati) përgjegjëse për programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, të personelit administrativ, si dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë, duke siguruar një bashkëpunim të vazhdueshëm të NjsBCZhK, me departamentet dhe studentët. Gjithashtu, në procesin e vlerësimin dhe të sigurimit të cilësisë së programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh janë të përfshirë edhe stafi akademik, të cilët me anë të mendimeve, sugjerimeve apo nevojave të tyre, kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të këtij programi studimi. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit përfshihen të gjithë aktorët kryesorë në rang njësie bazë dhe kryesore; anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. Në rastin konkret, studentët janë pjesë e GVB për vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>34 - RREGULLORE NJSBCZHK</p>

	<p>12 - MANUAL I NJSBCZHK Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore 1 – STATUTI I UMSH 16 - FORMULAR I STUDENTIT ALUMNI 22 - PROGRAM I TRAJNIMEVE 2020-2021 3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 – RREGULLORE E UMSH RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, si dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh, GVJ konstaton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektuar integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Sipas tyre, gjatë zhvillimit të pyetësorëve është ruajtur anonimati dhe integriteti akademik, si dhe duke respektuar parimet e etikës, të cilat janë të detyrueshme për tu ndjekur për të gjithë palët e përfshira. Sipas drejtuesve të IAL UMSH, nuk kanë patur asnjë rast të ngritur ose të regjistruar të diskriminimit apo pabarazisë së ushtruar ndaj personelit ose studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i> 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 12 - MANUAL I NJSBCZHK Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore 1 – STATUTI I UMSH 16 - FORMULAR I STUDENTIT ALUMNI 22 - PROGRAM I TRAJNIMEVE 2020-2021 3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 – RREGULLORE E UMSH RVB e IAL UMSH</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të</p>	<p>Në takimin me drejtues të IAL UMSH, ata specifikojnë që në procesin e vlerësimit, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike i UMSH ka përfshirë edhe aktorë apo bashkëpunëtorë të</p>



<p>jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>jashtëm, në nivel eksperti, si dhe ka zhvilluar tryeza dhe takime të ndryshme me biznese dhe sipërmarrje në mënyrë që të vlerësohet qëndrueshmëria e programit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh, përshtatja e njohurive me tregun e punës etj. GVJ mendon se duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata.</p> <p><i>Evidenca:</i> 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore 1 - STATUTI I UMSH 16 - FORMULAR I STUDENTIT ALUMNI 22 - PROGRAM I TRAJNIMEVE 2020-2021 3 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MPHMP 20 - PLAN PUNE MPHMP PER KONTROLLIN E PROCESIT MESIMOR 21 - FORMULARI I VLERESIMIT TE PEDAGOGUT DHE LENDES NGA STUDENTI 23 - PROCEDURE E PUNES ME FOKUS GRUPE 16' - Vendim i krijimit te NJSBC-se dhe GVB-se 17 - Procedure pune e NJSBC 4 - RREGULLORE E UMSH RVB e IAL UMSH</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 1066 759 1137">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="759 1066 970 1137">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="970 1066 1171 1137">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1171 1066 1375 1137">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 1137 759 1202"></td> <td data-bbox="759 1137 970 1202"></td> <td data-bbox="970 1137 1171 1202"></td> <td data-bbox="1171 1137 1375 1202" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi VL5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimit me përfaqësues të NjsBCZhK se kjo njësi i bën transparente dhe i vë në dispozicion të të gjithë pjestarëve në IAL UMSH (personelit akademik dhe studentëve) politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e tjera në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Informacioni përcillet në institucion nëpërmjet departamenteve tek stafi dhe studentët nëpërmjet shkresave zyrtare apo raporteve të hartuara nga NjsBCZhK. Gjithashtu këto raporte bëhen publike dhe në faqen zyrtare të IAL UMSH: www.umsh.edu.al, ku NjsBCZhK ka një kategori të vetën në të cilën ajo publikon të dhënat më të rëndësishme për njësinë si dhe njëkohësisht publikon raporte, manualë, si dhe vlerësime që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>IAL UMSH i publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit që NjsBCZHK realizon, dhe i shpërndan në të gjitha nivelet brenda institucionit. Rezultatet e vlerësimeve për këtë program studimi do të përfshihen për herë të parë në raportin më të afërt që do të hartohet për këtë vit. GVJ konstaton se publikimi i të gjitha dokumentave dhe informacioneve (nga pyetësorët, etj) bëhet duke respektuar, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Ato janë të publikuara dhe në faqen web të IAL UMSH.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 5 – RREGULLORE E FSHPS</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që NjsBCZHK i analizon rezultatet e vlerësimit, dhe në bazë të këtyre rezultateve ajo ka nxjerrë konkluzione dhe ka dhënë rekomandime & plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive që janë evituar. Vlerësimet që kanë të bëjnë me programin e lëndës, si dhe me programin e studimit, mësimdhënien apo literaturën etj., shoqërohen prej komenteve, vërejtjeve nëse ka të tilla, nga të cilat rrjedhin edhe masat që njësi bazë/departamenti dhe ajo kryesore/dekanati marrin parasysh dhe adresojnë për zgjidhje tek stafi akademik, ndihmës akademik, administrativ, apo tek studentët. Gjatë takimit me Përgjegjësen e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, si dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, GVJ u informua se raportet e NjsBCZHK analizohen në mbledhjet e departamentit dhe dekanatit, dhe merren masa për zgjidhjen e tyre rast pas rasti. Është detyrë e autoriteteve drejtuese brenda fakultetit dhe njësive bazë që të angazhohen për të adresuar drejtë zgjidhjen e problemeve dhe për të shmangur risqet potenciale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 5 – RREGULLORE E FSHPS</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se NjSBCZhK monitoron dhe vlerëson cilësinë nëpërmjet mekanizmave të saj, ndërsa dekanati dhe departamenti luajnë një rol kyç në kontrollin e zbatimit të masave të marra dhe analizojnë ndikimin e tyre, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë duke përfshirë në rastin konkret dhe programin e studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. Nëpërmjet strategjive dhe objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve dhe anketimeve, angazhimit të ekspertëve dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative, IAL UMSH siguron efektivitetin e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në institucion dhe në programet e studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 5 – RREGULLORE E FSHPSP</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Gjatë takimit me Përgjegjësen e Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, GVJ u informua se ata organizojnë vazhdimisht takime me personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ, dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Objektivi nuk është vetëm informimi por edhe pjesëmarrja e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. Zhvillohen mbledhje periodike (të përmuajshme) dhe të vazhdueshme të departamentit apo dekanatit (në raste të caktuara dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve) me qëllim diskutimin mbi problematika të ndryshme mbi ecurinë e procesit mësimor apo çështje të tjera të ngjashme, si dhe adresimin e tyre për zgjidhje nga strukturat përgjegjëse përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, NjSBCZhK organizon takime dhe veprimtari periodike për ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve për sigurimin e cilësisë në IAL UMSH (por edhe në programet e studimit), si dhe ka zhvilluar takime të ndryshme me stafin akademik të Departamentit të Administrimit Publik dhe Formimit Bazë për të diskutuar mbi proceset e vlerësimit të programeve të studimit, vlerësimin e programit të lëndëve, si dhe mbi rregulloret që standardizojnë sigurimin e cilësisë në IAL UMSH.</p> <p><i>Evidenca:</i> Linku: https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore Linku: https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise 12 - MANUAL I NJSBCZHK 34 - RREGULLORE NJSBCZHK 5 – RREGULLORE E FSHPSP</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Takimi në IAL UMSH			
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Takimi në IAL UMSH			
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Eksperienca e UMSH siguron cilësinë e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar ekspertë në fushën e Menaxhimit të Projektit.
2. Infrastruktura e ofruar. UMSH siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe e pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.
3. Stafit akademik i UMSH_{se} është i kualifikuar, me eksperiencë dhe me ekspertizën profesionale në fushat përkatëse të mësimdhënies.
4. Sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar platforma (si psh. sistemi SMS) që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.

Pika të dobëta

1. Pjesa më e madhe e stafit akademik që janë të angazhuar në këtë program studimi nuk janë përfaqësues të departamentit në të cilin programi është i atashuar. Kjo ndikon në procesin e përmirësimit dhe analizimit të kurrikulave. (Standardi I.4./kriteri 2)
2. Mungesa e marrëveshjeve konkrete të bashkëpunimit për këtë program studimi. Psh., duheshin dërguar nga IAL disa marrëveshje për zhvillimin e praktikave, për këtë program studimi, me institucione publike, të pavarura, të pushtetit lokal dhe kompani private?! (Standardi I.5/kriteri 3)
3. Mungon një raport i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi. Pra, duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet

operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vete). (GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë çfarë është vënë si evidencë, dhe mendon që duhej vënë si evidencë). (Standardi IV.6//kriteri 1, 2)

Rekomandime

1. GVJ gjykon se është e nevojshme përfshirja e lektorëve me kohë të pjeshme të cilët janë specialistë të fushave të projektit. Kjo përfshirje rrit cilësinë e formimit të studentëve. **II.2.3**
2. GVJ sugjeron pasurimin e kurrikulës me më shumë lëndë me zgjedhje të cilat i vijnë në ndihmë studentit në formimin e tij. **III.7.1**
3. GVJ sugjeron që të caktohet me vendim një fond i caktuar për financimin e botimeve të pedagogëve për çdo vit akademik, pra duhet theksuar që duhet më shumë angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. **IV.2.2**
4. Pavarësisht se IAL UMSH ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave për të mbështetur nevojat e programit MP në Hartim, Menaxhim Projektsh. **IV.4.2**
5. Numri i kompjuterave/laptopëve është i vogël dhe sugjerohet shtimi i tyre në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës. **IV.4.4**
6. GVJ sugjeron që duhej miratuar dhe paraqitur një Rregullore e Sekretarisë Mësimore dhe një Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore! **IV.5.1 & IV.5.2**
7. Nga GVJ sugjerohet që të bëhet më shumë punë për të rritur numrin e regjistrimeve të studentëve që ndjekin studimet MP në Hartim, Menaxhim Projektsh, kjo për të ndikuar në të ardhurat e IAL UMSH, por dhe për të fuqizuar këtë program studimi dhe për ta përmirësuar më tej. **V.4.3**
8. GVJ mendon që analiza e tregut të punës duhej më e zgjeruar. **V.4.5**
9. GVJ sugjeron që NjSBC të ishte e 'pastër' dhe më e fokusuar, kurse për pjesën e kurrikulave të krijohej Komisioni i Përhershëm për Zhvillimin e Kurrikulave, dhe puna e tij të ishte më e specializuar dhe fokusuar, gjë e cila do të sillte më shumë efikasitet dhe efektivitet. GVJ mendon se duhej më shumë informacion se si përfshihen ekspertët e jashtëm dhe cilët janë ata. **VI.2.1. & VI.4.1. & VI.4.5. & VI.1.2**

10. GVJ sugjeron që raportet e përvitshme financiare duheshin dhe të detajuara në nivel fakulteti dhe departamenti, apo për programin specifik të studimit MP në Hartim, Menaxhim Projektesh. **IV.6.4**

Conclusions of the evaluation of the study program of the second cycle Professional Master in “Design, Project Management” of the Higher Education Institution “Mediterranean University of Albania - UMSH”

Strengths and affirmations

1. The experience of UMSH ensures the sufficient and appropriate quality to train experts in the field of Project Management.
2. Infrastructure provided. UMSH provides sufficient and appropriate learning environments for organizing theoretical teaching activities. The infrastructure is adequate and equipped with lecture and seminar auditoriums, laboratories, and library.
3. The academic staff of UMSH is qualified, experienced, and has professional expertise in the relevant fields of teaching.
4. The information management system has integrated platforms (such as the SMS system) that enable forms of interactive communication and information exchange between staff and students.

Weaknesses

1. Most of the academic staff who is engaged in this study program is not representatives of the department in which the program is assigned/affiliated. This affects the process of curriculum improvement and analysis. **(Standard I.4/criterion 2)**
2. Lack of concrete cooperation agreements for this study program. For example, the HEI should have sent some agreements for the organization of internships for this study program, with public, independent, local government institutions, and private companies?! **(Standard I.5/criterion 3)**
3. There is a lack of a complete financial report of the costs of the study program and the plan for the financial support necessary for its success for at least one full study cycle. Therefore, it is needed the financing plan of the study program (which contains the financing of human resources for this program, the operating expenses for the maintenance of the environments and technologies supporting the learning process, etc.), as well as in the financing plan to be specified and foreseen as an item of expenditure for the library and the enrichment of literature and access to on-line libraries (although this could be included in another item of expenditure, but it is recommended as an item itself!). (External Evaluation Group - EEG in the answer is

based on the relevant criterion of the standard and what was put as evidence and thinks that it should have been put as evidence). (Standard IV.6/ criteria 1, 2)

Recommendations

1. EEG suggests to involve in teaching part-time lecturers who are specialists in the fields of the projects, which impacts the quality of students learning. **II.2.3**
2. EEG suggests enriching the curriculum with more optional subjects/courses which help the students. **III.7.1**
3. EEG suggests that a certain fund for the financing of lecturers publications to be set by decision for each academic year, so it should be emphasized that more practical, real commitment and promotion from HEI is needed for the academic staff for various publications in prestigious scientific journals abroad and participation in scientific conferences. **IV.2.2**
4. Despite the fact that HEI UMSH has made considerable efforts to enrich the literature (titles) in the library, there is still room for adding book titles to support the needs of the Professional Master program in Design, Project Management. **IV.4.2**
5. The number of computers/laptops is small and it is suggested to add them to the library to better serve students' navigation in online literature resources. **IV.4.4**
6. EEG suggests that a Regulation of the Teaching Secretariat and a Regulation of the Human Resources Office had to be approved and presented! **IV.5.1 & IV.5.2**
7. EEG suggests that more efforts should be done to increase the number of registrations/enrollments of students who attend master studies in Design, Project Management, this to affect the income of HEI UMSH, but also to strengthen this study program and improve it further. **V.4.3**
8. EEG thinks that the labor market analysis should be more expanded. **V.4.5**
9. EEG suggests that Internal Quality Assurance Unit (IQUA) should be separated and more focused, while for the part of curricula, a Permanent Commission for Curriculum Development should be created, and its work should be more specialized and focused, which would bring more efficiency and effectiveness. EEG thinks that more information was needed on how external experts are involved and who they are. **VI.2.1. & VI.4.1. & VI.4.5. & VI.1.2**
10. EEG suggests that UMSH annual financial reports should have been detailed at the faculty and department level, or for the specific professional master study program in Design, Project Management. **IV.6.4**

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushja e plotë	Përbushja pjesërisht	Përbushja kryesisht	Përbushja plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

